FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 39

Tiranë – E premte, 10 mars 2023

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 131, datë 8.3.2023	Për lirim nga detyra	4317
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 132, datë 8.3.2023	Për emërim në detyrë	4317
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 133, datë 8.3.2023	Për emërim në detyrë	4317
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 134, datë 8.3.2023	Për një ndryshim në vendimin nr. 763, datë 12.12.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e masës së shtesës për natyrë të veçantë pune për drejtorin e përgjithshëm dhe nëpunësit në njësitë teknike të përmbajtjes së Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike"	4317
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 135, datë 8.3.2023	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit "Ujësjellësi i fshatit Duhanas, fshati Lapardha 1, Otllak dhe Orizaj", Berat	4318
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 137, datë 8.3.2023	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga projekti "Mbikalim këmbësorësh, Bahçallëk"	4319
Urdhër i drejtorit të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar nr. 81, datë 6.3.2023	Për delegim të përkohshëm të kompetencave	4321
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 32, datë 20.2.2023	Mbi shqyrtimin e kërkesës së Shoqatës Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë (AAES) për disa ndryshime në zbatimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 23, datë 14.2.2022	4321
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 33, datë 20.2.2023	Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 397, seria PV18K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Kryezi", dhënë shoqërisë "Alesio-2014" sh.p.k.	4323

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 34, datë 20.2.2023	Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 420, seria P18, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Fushë-Arrëz", dhënë shoqërisë "Alesio-2014" sh.p.k.	4324
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 35, datë 20.2.2023	Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 449, seria P19, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "BE-IS Energy" sh.p.k.....	4326
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 36, datë 20.2.2023	Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 388, seria PV17K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Afrimi K" sh.p.k	4327
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 37, datë 20.2.2023	Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 10, seria PV03, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "EN.KU" sh.p.k.....	4329
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 38, datë 20.2.2023	Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 185, seria PV12K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhënë shoqërisë "Energji-Xhaçi" sh.p.k.....	4330
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 39, datë 20.2.2023	Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 415, seria P18K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhënë shoqërisë "Blac Energy" sh.p.k	4332
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 40, datë 20.2.2023	Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 14, seria PV03P, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Juana" sh.p.k	4333
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 41, datë 20.2.2023	Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 129, seria PV11K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Selishte" sh.p.k.	4335
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 42, datë 20.2.2023	Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 392, seria PV17K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Sima-Com" sh.p.k.....	4336
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 43, datë 20.2.2023	Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 125, seria PV11K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "HEC-i Dragostunje" sh.p.k	4338
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 44, datë 20.2.2023	Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 126, seria T11P, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "HEC-i Dragostunje" sh.p.k	4339
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 45, datë 20.2.2023	Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 280, seria PV15K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Koxherri Energji" sh.p.k	4341
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 46, datë 20.2.2023	Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 292, seria T15P, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Koxherri Energji" sh.p.k	4342
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 47, datë 20.2.2023	Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 136, seria T11P, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Erma M.P." sh.p.k.	4344

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 48, datë 20.2.2023	Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 454, seria T19, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Electral Batra HPP" sh.p.k	4345
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 49, datë 20.2.2023	Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 446, seria T19, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Terna Energy Trading" sh.p.k	4347
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 50, datë 20.2.2023	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë "Sun Energy Solutions" sh.p.k në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 mw, në Sheq Marinas, Topojë, Bashkia Fier.....	4348
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 51, datë 20.2.2023	Mbi mos fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë "Energy 24" sh.p.k në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike	4350
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 52, datë 20.2.2023	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë "Ateani Energy" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet "Shutri 1", me kapacitet të instaluar 370 kw dhe "Shutri 2", me kapacitet 1600 kw, me kapacitet total të instaluar 1970 kw.....	4351
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 53, datë 20.2.2023	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë "Ateani Energy" sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	4353
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 5, datë 22.2.2023	Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Tiranë sh.a.....	4354
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 6, datë 22.2.2023	Për licencimin e shoqërisë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Durrës sh.a.....	4355
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 7, datë 22.2.2023	Për licencimin e shoqërisë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Gjirokastër sh.a.....	4357
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 8, datë 22.2.2023	Për një shtesë në vendimin nr. 420, datë 29.9.2022, "Për licencat dhe tarifat e shërbimit të operatorëve UK deri në përfundim të procedurave të riorganizimit dhe transferimit të shoqërive UK në subjekte me kompetenca të përbashkëta".....	4358
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 222/5, datë 28.2.2023	Për shpronësimin, dhe/ose për shkëmbimin e pronës për disa shtesa dhe ndryshime në VKM –në nr. 345, datë 10.6.2021, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private dhe shkëmbimin e pronës, në funksion të procesit të rindërtimit, në zonën e re për zhvillim, në Njësinë Administrative Vorë, Bashkia Vorë, faza I.....	4359
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 20/8, datë 10.3.2023	Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti "Ndërtimi i Rrugës Shëngjin–Baks-Rrjoll, segmenti nga km +0.00 deri në km 7+310".....	4361

VENDIM
Nr. 131, datë 8.3.2023

PËR LIRIM NGA DETYRA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Besart Kadia, zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 132, datë 8.3.2023

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Endrit Yzeiraj emërohet zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 133, datë 8.3.2023

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Besart Kadia emërohet zëvendësministër për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 134, datë 8.3.2023

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 763, DATË 12.12.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË SHTESËS PËR NATYRË TË VEÇANTË PUNE PËR DREJTORIN E PËRGJITHSHËM DHE NËPUNËSIT NË NJËSITË TEKNIKE TË PËRMBAJTJES SË AUTORITETIT KOMBËTAR PËR CERTIFIKIMIN ELEKTRONIK DHE SIGURINË KIBERNETIKE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", dhe të pikës 5/1, të nenit 10, të ligjit nr. 9880, datë 25.2.2008, "Për nënshkrimin elektronik", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr. 1 e vendimit nr. 763, datë 12.12.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e masës së shtesës për natyrë të veçantë pune për drejtorin e përgjithshëm dhe nëpunësit në njësitë teknike të përmbajtjes së Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike", zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lidhja nr. 1

MASA E SHTESËS PËR NATYRË TË VEÇANTË PUNE PËR DREJTORIN E PËRGJITHSHËM DHE NËPUNËSIT E NJËSIVE TEKNIKE TË PËRMBAJTJES SË AUTORITETIT KOMBËTAR PËR CERTIFIKIMIN ELEKTRONIK DHE SIGURINË KIBERNETIKE

NR. RENDOR	POZICIONI	MASA E SHTESËS PËR NATYRË TË VEÇANTË PUNE
1	Titullar i institucionit	800 000
2	Zëvendësdrejtor i përgjithshëm dhe drejtor drejtorie në drejtoritë e përmbajtjes përgjegjëse për funksionet e konformitetit të certifikimeve, qeverisjes së sigurisë kibernetike, kontrollit të masave të sigurisë kibernetike, zhvillimit strategjik, analizës së riskut, analizës së sigurisë kibernetike, monitorimit dhe reagimit të incidenteve.	280 000
3	Përgjegjës sektori në sektorët e përmbajtjes përgjegjës për funksionet e konformitetit të certifikimeve, garantimit të transaksioneve elektronike në treg, kontrollit të masave të sigurisë kibernetike, simulimit, monitorimit të thelluar, reagimit të incidenteve kibernetike, analizës së riskut, analizës së sigurisë kibernetike, menaxhimit të incidenteve kibernetike, qeverisjes së sigurisë kibernetike, mbrojtjes kibernetike dhe hetimit të incidenteve kibernetike	220 000
4	Përgjegjës sektori në sektorët e përmbajtjes përgjegjës për funksionet e monitorimit të jashtëm, politikave, çështjeve ligjore, analizës së indikatorëve, statistikave dhe modeleve, komunikimit, ndërgjegjësimit dhe zhvillimeve strategjike	150 000
5	Specialist në drejtoritë apo sektorët e përmbajtjes përgjegjës për funksionet e konformitetit të certifikimeve, garantimit të transaksioneve elektronike në treg, kontrollit të masave të sigurisë kibernetike, simulimit, monitorimit të thelluar, reagimit të incidenteve kibernetike, analizës së riskut, analizës së sigurisë kibernetike, menaxhimit të incidenteve kibernetike, qeverisjes së sigurisë kibernetike, mbrojtjes kibernetike dhe hetimit të incidenteve kibernetike	190 000
6	Specialist në drejtoritë apo sektorët e përmbajtjes përgjegjës për funksionet e monitorimit të jashtëm, politikave, çështjeve ligjore, analizës së indikatorëve, statistikave dhe modeleve, komunikimit, ndërgjegjësimit dhe zhvillimeve strategjike	120 000

VENDIM
Nr. 135, datë 8.3.2023

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "UJËSJELLËSI I FSHATIT DUHANAS, FSHATI LAPARDHA 1, OTLLAK DHE ORIZAJ", BERAT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit "Ujësjellësi i fshatit Duhanas, fshati Lapardha 1, Otllak dhe Orizaj", Berat.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Berat.

3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohet, kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasurinë e llojit "arë", me një vlerë të përgjithshme prej 137 025 (njëqind e tridhjetë e shtatë mijë e njëzet e pesë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 137 025 (njëqind e tridhjetë e shtatë mijë e njëzet e pesë) lekësh, përballohet nga buxheti i Bashkisë Berat.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekësh, përballohet nga Bashkia Berat.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronari i pasurisë së paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohet për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Berat.

8. Bashkia Berat kryen procedurat për likuidimin e pronarit të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Berat.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat, pezullon të gjitha transaksionet me pasurinë e shpronësuar, deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron kalimin e pronësisë për pasurinë e shpronësuar në favor të Bashkisë Berat, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron kalimin e pronësisë në favor të Bashkisë Berat për pasurinë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Berat, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Berat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

TABELA E SHPRONËSIMIT TË PRONARIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "UJËSJELLËSI I FSHATIT DUHANAS, FSHATI LAPARDHA 1, OTLLAK DHE ORIZAJ", BERAT

NR.	PRONARI			TË DHËNA HIPOTEKARE						VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM			Vlera totale	SHËNIME (D+E Kufizime hipotekare, barrë mbi pasurinë etj.)
										ARË				
	EMRI	ATËSIA	MBIEMRI	Fshati ose qyteti	Zona kadastrale	Nr. pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Arë (m²)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lek/m²)	Vlera (lek)		
	A	B	C	Ç	Ç	D	E	F	G	L	M	N		Z
1	Sulo	Reshep	Toska	Berat	1561	181/6	Arë	1200	1200	675	203	137,025.00	137,025.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
VLERA TOTALE													137,025.00	

VENDIM
Nr. 137, datë 8.3.2023

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA PROJEKTI "MBIKALIM KËMBËSORËSH, BAHÇALLËK"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga projekti "Mbikalim këmbësorësh, Bahçallëk".

2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurisë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasurinë e llojit "truall", me një vlerë të përgjithshme prej 2 978 850 (dy milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e pesëdhjetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 2 978 850 (dy milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e pesëdhjetë) lekësh, përballohet nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurisë së paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Autoriteti Rrugor Shqiptar kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të kalimit të pronësisë në favor të shtetit në përgjegjësi administrimi të Autoritetit Rrugor Shqiptar të pasurisë që shpronësohet, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Shkodër, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron kalimin e pronësisë për pasurinë e shpronësuar në favor të shtetit në përgjegjësi administrimi të Autoritetit Rrugor Shqiptar, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Shkodër, dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "MBIKALIM KËMBËSORËSH, BAHÇALLËK"

	TË DHËNAT E PRONËSISË		TË DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË)			TË DHËNAT E PASURISË TOKE TRUALL QË SHPRONËSOHET				KUFIZIME HIPOTEKARE	Adresa e pronarit
Nr.	Emri	Mbiemri	Nr. i pas.	ZK	Sip. totale	Sip. e shpronësuar (m²)	ÇMIMI (lek/m²)	Vlera (lek)	Vlera totale	Shënime	
1	Esat	Malevija	17/638	8591	350	350	8511	2978850	2978850	Konfirmime nga ASHK-ja	Bashkia Shkodër RR/l Bahçallëk
	Hava	Malevija									
	Daut	Malevija									
	Rifat	Malevija									
	Hajrullah	Malevija									
	Shuajp	Malevija									
	Halid	Jula									
	Ermira	Jula									
	Bardhyl	Jula									
	Satbere	Jula									
	Qemal	Bashli									
	Suzana	Bashli									
	Nezihate	Bashli									
	Agron	Bashli									
	Halit	Bashli									
	Lirije	Bashli									
	Valbona	Bashli									
	Bajram	Bashli									
	Milihat	Bashli									
	Nazmi	Bashli									
	Ermira	Bashli (Kadija)									
	Zamir	Bashli (Hoxha)									
	Saime	Bashli (Salko)									
	Ylvet	Demi									
	Durrije	Demi									
	Ali	Demi									
	Zija	Demi									
VLERA TOTALE								2978850	2978850		

URDHËR
Nr. 81, datë 6.3.2023

PËR DELEGIM TË PËRKOHSHËM TË KOMPETENCAVE

Në zbatim të neneve 28 dhe 29, të Kodit të Procedurave Administrative, të VKM nr. 58, datë 29.1.2004, "Për organizimin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar", nenit 26, të rregullores së brendshme të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, miratuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 1, datë 14.1.2015, "Për miratimin e rregullores së brendshme të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK)", i ndryshuar.

URDHËROJ:

1. Delegimin e përkohshëm të kompetencave të mëposhtme të titullarit të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, me përjashtim të kompetencave të cilat nuk delegohen dhe që janë të shprehura me ligj, drejtorit të Drejtorisë së Sigurimit, Administrimit të Dokumenteve dhe Regjistrit Qendror, z. Agron Cani.

2. Z. Agron Cani i delegohen kompetencat si më poshtë:

- Ndjek dhe zbaton "Rregulloren për funksionimin dhe organizimin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar", i ndryshuar;
- Ndjek dhe monitoron prezencën në punë të personelit të DSIK-së;
- Ndjek detyrat e vendosura në planin mujor;
- Merr dhe trajton korrespondencën shkresore.

3. Kompetencat e mësipërme delegohen për periudhën nga data 9.3.2023 deri më 3.4.2023.

4. Z. Agron Cani nuk mund ti nëndelegojë këto kompetenca.

5. Për ndjekjen e këtij urdhri ngarkohet drejtori i Drejtorisë së Sigurimit, Administrimit të Dokumenteve dhe Regjistrit Qendror.

6. Me njohjen dhe zbatimin e këtij urdhri ngarkohen të gjithë nëpunësit/punonjësit e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.

7. Ky urdhër hartohet në 3 (tri) kopje të njëjta, një për Protokoll-Arkivin, dhe një për drejtorin e Drejtorisë së Sigurimit, Administrimit të Dokumenteve dhe Regjistrit Qendror dhe një për QBZ.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Dorian Tola

VENDIM
Nr. 32, datë 20.2.2023

MBI SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQATËS SHQIPTARE TË FURNIZUESVE TË ENERGJISË (AAES) PËR DISA NDRYSHIME NË ZBATIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-s NR. 23, DATË 14.2.2022

Në mbështetje të nenit 10, nenit 16 dhe nenit 18, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike" i ndryshuar; si dhe nenit 25, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.02.2023, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit, Performancës dhe Standardeve me nr. 887 prot., datë 17.2.2023, "Mbi shqyrtimin e kërkesës së AAES për disa ndryshime dhe kufizime në zbatimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 23, datë 14.2.2022",

konstatoi se:

- Shoqata Shqiptare e Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES), me anë të shkresës me nr. 8/1 prot., datë 30.12.2022, protokolluar në ERE me nr. 2150 prot, datë 30.12.2022, si dhe shkresës plotësuese protokolluar në ERE me nr. 8/2 prot., datë 16.2.2023, ka paraqitur kërkesën lidhur me shtyrjen e pjesshme të aplikimit të dispozitave të "Rregullores mbi masat e të licencuarve në aktivitetin e furnizimit për arritjen e treguesve të matjes dhe vlerësimit nga ERE të performancës së shërbimit ndaj klientit", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 23, datë 14.2.2022. Këto propozime konsistojnë në ndërhyrje në "Rregulloren mbi masat e të licencuarve në aktivitetin e furnizimit për arritjen e treguesve të matjes dhe vlerësimit nga ERE të performancës së shërbimit ndaj klientit", në nenin 1, pika 1.2, germat "a", "b", "d", "e", "f", "g" dhe "j", në

nenin 2, pikat 1 dhe 2, si dhe në nenin 4, pikat 1 dhe 2, ku në fund të çdo paragrafi kërkohet të shtohet: (e aplikueshme vetëm për furnizuesit që furnizojnë klientë fundorë të lidhur në tension të ulët si dhe për furnizuesit që furnizojnë klientë fundorë të lidhur në tension të ulët dhe të mesëm).

- Kërkesa e përcjellë nga AAES është e mbështetur në vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 872, datë 27.12.2022, "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 519, datë 13.7.2016, të Këshillit të Ministrave, 'Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike"' dhe është e vlefshme për të njëjtën periudhë kohore të përcaktuar në aneksin 1, specifikisht deri më datë 31.12.2023.

- Për sa u përket aspekteve procedurale të shqyrtimit të kërkesës, rezulton se referuar parashikimeve të nenit 6, pikës 3, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, si dhe nenit 3, pikës 7, të "Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Shoqata e Furnizuesve të Energjisë Elektrike AAES, plotëson kriteret e palës së interesuar, e cila mund t'i kërkojë ERE-s, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabimet materiale të konstatuara.

- AAES këtë kërkesë e ka paraqitur në ERE si përfaqësues i Shoqatës Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë Elektrike dhe si e tillë ka interes të ligjshëm për të mbrojtur furnizuesit dhe, rrjedhimisht, legjitimohet si palë në këtë procedurë administrative për të sjellë kërkesën për rishikim.

- Në nenin 144, të ligjit nr. 44/2015, të "Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", përcaktohet se: *2. Pala mund të kërkojë rishikim, nëse zbulohen rrethana ose prova të reja me shkresë që kanë rëndësi për çështjen, të cilat nuk diheshin dhe mund të diheshin prej saj gjatë zhvillimit të procedurës administrative që ka çuar në nxjerrjen e aktit administrativ.*

- Në objektivat e ERE-s, të parashikuar në nenin 18, germa "d", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, parashikohet se, përgjegjësi e ERE-s, mes të tjerave është angazhimi në zhvillimin e një sistemi të sigurt, të qëndrueshëm, jodiskriminues dhe në mbrojtje të konsumatorit, në përputhje me objektivat e zhvillimit të sektorit të energjisë elektrike, eficiencës së energjisë elektrike, si dhe integrimi në shkallë të gjerë të prodhimit të energjisë nga burimet e energjisë së rinovueshme.

- ERE vlerëson se pavarësisht kërkesës së AAES për aplikimin e përjashtimeve të propozuara vetëm për furnizuesit që furnizojnë konsumatorë të lidhur në tension të mesëm dhe të lartë, parimi i mos diskriminimit të të gjithë pjesëmarrësve të tregut duhet të prevalojë në trajtimin e kësaj kërkese duke përfshirë të gjithë furnizuesit që ushtrojnë aktivitet në treg të lirë, për konsumatorë të lidhur në të gjitha nivelet e tensionit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI

1. Fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës të Shoqatës Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë (AAES) për disa ndryshime në zbatimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 23, datë 14.2.2022 "Mbi miratimin e rregullores mbi masat e të licencuarve në aktivitetin e furnizimit për arritjen e treguesve të matjes dhe vlerësimit nga ERE të performancës së shërbimit ndaj klientit".

2. Të gjithë furnizuesit që ushtrojnë aktivitetin e furnizimit në treg të lirë përjashtohen deri në datë 31.12.2023 nga detyrimi për implementimin e masave të parashikuara në nenin 1.2 germat "a", "b", "d", "e", "f", "g" dhe "j", në nenet 2.1 dhe 2.2 si dhe në nenet 4.1. dhe 4.2.

3. Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit, Performancës dhe Standardeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 33, datë 20.2.2023

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS NR. 397, SERIA PV18K, PËR VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC "KRYEZI", DHËNË SHOQËRISË "ALESIO-2014" SHPK

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 42, pika 1, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; nenit 5, germa "ç"; neneve 6 dhe 7, të rregullores "Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 58, datë 18.4.2017; nenit 15 të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; pikës 6.1, germa "ç", të "Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.2.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 505/1 prot., datë 15.2.2023, të përgatitur nga grupi i punës, "Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitore për pagesat e rregullimit të vitit 2022 të pashlyera ndaj ERE-s",

konstatoi se:

- Shoqëria "Alesio-2014" sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 397, seria PV18K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Kryezi", dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 34, datë 9.2.2018, për një afat 30-vjeçar.

- Me vendimin e bordit nr. **124,** datë 31.5.2022, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2022 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror.

- Vendimi i Bordit të ERE-s nr. 124/2022 është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 101, datë 7.7.2022. Përveç botimit në Fletoren Zyrtare, i licencuari është njoftuar për këtë vendim, edhe nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 1315 prot., datë 21.7.2022. Po ashtu, shoqërisë i është rinjoftuar detyrimi nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 1575 prot., datë 20.9.2022. Rezulton se shoqëria nuk e ka shlyer ende detyrimin e saj.

- Me urdhrin e kryetarit nr. 20, datë 30.1.2023, është ngritur grupi i punës për marrjen e masave administrative ndaj të licencuarve debitorë për pagesat e rregullimit të vitit 2022, të pashlyera ndaj ERE-s.

- Rezulton se i licencuari "Alesio-2014" sh.p.k. nuk e ka kundërshtuar vendimin e Bordit të ERE-s nr. 124/2022, dhe nuk ka përcjellë në ERE shpjegime dhe dokumentacion mbi moshlyerjen e pagesës së rregullimit të vitit 2022.

- Grupi i punës ka konstatuar nga ana e shoqërisë "Alesio-2014" sh.p.k. shkeljen si vijon: mosshlyerjen në afat të pagesës së rregullimit për vitin 2022.

- Ligji nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, në nenin 107, parashikon se: për moskryerjen e pagesës rregullatore nga ana e të licencuarit brenda afatit të përcaktuar, ERE ndëshkon me gjobë deri në 3 për qind të të ardhurave të vitit paraardhës të të licencuarit si dhe ka të drejtë të aplikojë një kamatëvonesë mbi vlerën e pagesës rregullatore, në masën e 0.2 % të xhiros ditore për çdo ditë vonesë në pagesën e saj dhe në germën "ç", të nenit 42, parashikon se: ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17 i këtij ligji.

- Sa i përket masës administrative "gjobë", referuar parashikimeve të sipërcituara ligjore, kalkulimi i masës së gjobës bëhet mbi bazën e të ardhurave vjetore të vitit financiar paraardhës të të licencuarit. Në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore dhe në bazë të të dhënave të ushtrimit të aktivitetit të licencuar, rezulton se kjo masë nuk mund të aplikohet për të gjitha subjektet debitore ndaj pagesës së rregullimit të vitit 2021, pasi ka subjekte të cilët nuk e kanë ushtruar veprimtarinë e licencuar për vitin paraardhës e për këtë arsye në zbatim të "Rregullores mbi përcaktimin e miratimin e pagesave rregullatorë", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 190, datë 23.11.2017, e ndryshuar, i është vendosur shuma fikse.

- Duke qenë se ligji ka parashikuar të drejtën e ERE-s për të marrë masa administrative të përshkallëzuara për llojin e shkeljes (mosshlyerje e pagesave të rregullimit të vitit 2022) që nga vendosja e gjobës e deri në heqjen e licencës, vlerësohet që në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore, këta të licencuar të trajtohen në mënyrë të barabartë, duke qenë se shkelja është e njëjtë për të gjithë dhe të vijohet me masën administrative që mund të aplikohet për të gjithë këta të licencuar,

duke filluar me procedurat përkatëse për heqjen e licencës, sipas parashikimeve të nenit 5, germa "ç" dhe nenit 6, të rregullores "Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017.

- Neni 6 i rregullores "Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 52, datë 18.4.2017, parashikon se, në çdo rast, subjekti ndaj të cilit fillon një procedurë për heqjen e licencës duhet që, me marrjen dijeni, të shlyejë çdo pagesë rregullatore të pashlyer ndaj ERE. Në asnjë rast subjekti i licencuar debitor, nuk çlirohet nga ky detyrim ndaj ERE-s, edhe pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurës për heqjen e licencës.

- Në nenin 7 të rregullores është parashikuar e drejta e të licencuari për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 397, seria PV18K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Alesio-2014" sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 34, datë 9.2.2018.

2. I licencuari ka të drejtë për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

3. Grupi i punës të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 34, datë 20.2.2023

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS NR. 420, SERIA P18, PËR VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC "FUSHË-ARRËZ", DHËNË SHOQËRISË "ALESIO-2014" SHPK

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 42, pika 1, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike" i ndryshuar; nenit 5, germa "ç"; nenit 6 dhe 7 të rregullores "Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; nenit 15 të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; pikës 6.1, germa "ç", të "Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike" miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.2.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 505/1 prot., datë 15.2.2023, të përgatitur nga grupi i punës, "Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitore për pagesat e rregullimit të vitit 2022 të pashlyera ndaj ERE-s",

konstatoi se:

- Shoqëria "Alesio-2014" sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 420, seria P18, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Fushë-Arrëz", dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 180, datë 20.8.2018, për një afat 30-vjeçar.

- Me vendimin e Bordit nr. 124, datë 31.5.2022, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2022 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror.

- Vendimi i Bordit të ERE-s nr. 124/2022 është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 101, datë 7.7.2022. Përveç botimit në Fletoren Zyrtare, i licencuari është njoftuar për këtë vendim, edhe nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 1315 prot., datë 21.7.2022. Po ashtu, shoqërisë i është rinjoftuar detyrimi nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 1575 prot., datë 20.9.2022. Rezulton se shoqëria nuk e ka shlyer ende detyrimin e saj.

- Me urdhrin e kryetarit nr. 20, datë 30.1.2023, është ngritur grupi i punës për marrjen e masave

administrative ndaj të licencuarve debitorë për pagesat e rregullimit të vitit 2022, të pashlyera ndaj ERE-s.

- Rezulton se i licencuari "Alesio-2014" sh.p.k. nuk e ka kundërshtuar vendimin e Bordit të ERE-s nr. 124/2022, dhe nuk ka përcjellë në ERE shpjegime dhe dokumentacion mbi mosshlyerjen e pagesës së rregullimit të vitit 2022.

- Grupi i Punës ka konstatuar nga ana e shoqërisë "Alesio-2014" sh.p.k. shkeljen si vijon: mosshlyerjen në afat të pagesës së rregullimit për vitin 2022.

- Ligji nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, në nenin 107, parashikon se, për moskryerjen e pagesës rregullatore nga ana e të licencuarit brenda afatit të përcaktuar, ERE ndëshkon me gjobë deri në 3 për qind të të ardhurave të vitit paraardhës të të licencuarit si dhe ka të drejtë të aplikojë një kamatëvonesë mbi vlerën e pagesës rregullatore, në masën e 0.2 % të xhiros ditore për çdo ditë vonesë në pagesën e saj dhe në germën "ç", të nenit 42, parashikon se: ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17 i këtij ligji.

- Sa i përket masës administrative "gjobë", referuar parashikimeve të sipërcituara ligjore, kalkulimi i masës së gjobës bëhet mbi bazën e të ardhurave vjetore të vitit financiar paraardhës të të licencuarit. Në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore dhe në bazë të të dhënave të ushtrimit të aktivitetit të licencuar, rezulton se kjo masë nuk mund të aplikohet për të gjitha subjektet debitore ndaj pagesës së rregullimit të vitit 2021, pasi ka subjekte të cilët nuk e kanë ushtruar veprimtarinë e licencuar për vitin paraardhës e për këtë arsye në zbatim të rregullores "Mbi përcaktimin e miratimin e pagesave rregullatore", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 190, datë 23.11.2017, i ndryshuar, i është vendosur shuma fikse.

- Duke qenë se ligji ka parashikuar të drejtën e ERE-s për të marrë masa administrative të përshkallëzuara për llojin e shkeljes (mosshlyerje e pagesave të rregullimit të vitit 2022) që nga vendosja e gjobës e deri në heqjen e licencës, vlerësohet që në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore, këta të licencuar të trajtohen në mënyrë të barabartë, duke qenë se shkelja është e njëjtë për të gjithë dhe të vijohet me masën administrative që mund të aplikohet për të gjithë këta të licencuar, duke filluar me procedurat përkatëse për heqjen e licencës, sipas parashikimeve të nenit 5, germa "ç" dhe nenit 6 të rregullores "Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017.

- Neni 6 i rregullores "Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 52, datë 18.4.2017, parashikon se, në çdo rast, subjekti ndaj të cilit fillon një procedurë për heqjen e licencës duhet që, me marrjen dijeni të shlyejë çdo pagesë rregullatore të pashlyer ndaj ERE-s. Në asnjë rast subjekti i licencuar debitor nuk çlirohet nga ky detyrim ndaj ERE, edhe pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurës për heqjen e licencës.

- Në nenin 7 të rregullores është parashikuar e drejta e të licencuari për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 420, seria P18, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Alesio-2014" sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 180, datë 20.8.2018.

2. I licencuari ka të drejtë për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

3. Grupi i punës të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 35, datë 20.2.2023

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS NR. 449, SERIA P19, PËR VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË "BE-IS ENERGY" SHPK

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 42, pika 1, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; nenit 5, germa "ç"; nenit 6 dhe 7 të rregullores "Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; nenit 15 të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; pikës 6.1, germa "ç", të "Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike" miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.2.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 505/1 prot., datë 15.2.2023, të përgatitur nga grupi i punës, "Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitore për pagesat e rregullimit të vitit 2022 të pashlyera ndaj ERE-s",

konstatoi se:

- Shoqëria "BE-IS Energy" sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 449, seria P19, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 115, datë 22.7.2019, për një afat 30-vjeçar.

- Me vendimin e Bordit nr. 124, datë 31.5.2022, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2022 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror.

- Vendimi i Bordit të ERE-s nr. 124/2022 është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 101, datë 7.7.2022. Përveç botimit në Fletoren Zyrtare, i licencuari është njoftuar për këtë vendim, edhe nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 1326 prot., datë 21.7.2022. Po ashtu, shoqërisë i është rinjoftuar detyrimi nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 1578 prot., datë 20.9.2022. Rezulton se shoqëria nuk e ka shlyer ende detyrimin e saj.

- Me urdhrin e kryetarit nr. 20, datë 30.1.2023, është ngritur grupi i punës për marrjen e masave administrative ndaj të licencuarve debitorë për pagesat e rregullimit të vitit 2022, të pashlyera ndaj ERE-s.

- Rezulton se i licencuari "BE-IS Energy" sh.p.k. nuk e ka kundërshtuar vendimin e Bordit të ERE-s nr. 124/2022, dhe nuk ka përcjellë në ERE shpjegime dhe dokumentacion mbi mosshlyerjen e pagesës së rregullimit të vitit 2022.

- Grupi i Punës ka konstatuar nga ana e shoqërisë "BE-IS Energy" sh.p.k. shkeljen si vijon: mosshlyerjen në afat të pagesës së rregullimit për vitin 2022.

- Ligji nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, në nenin 107, parashikon se: për moskryerjen e pagesës rregullatore nga ana e të licencuarit brenda afatit të përcaktuar, ERE ndëshkon me gjobë deri në 3 për qind të të ardhurave të vitit paraardhës të të licencuarit si dhe ka të drejtë të aplikojë një kamatëvonesë mbi vlerën e pagesës rregullatore, në masën e 0.2% të xhiros ditore për çdo ditë vonesë në pagesën e saj dhe në germën "ç", të nenit 42 parashikon se, ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17 i këtij ligji.

- Sa i përket masës administrative "gjobë", referuar parashikimeve të sipërcituara ligjore, kalkulimi i masës së gjobës bëhet mbi bazën e të ardhurave vjetore të vitit financiar paraardhës të të licencuarit. Në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore dhe në bazë të të dhënave të ushtrimit të aktivitetit të licencuar, rezulton se kjo masë nuk mund të aplikohet për të gjitha subjektet debitore ndaj pagesës së rregullimit të vitit 2021, pasi ka subjekte të cilët nuk e kanë ushtruar veprimtarinë e licencuar për vitin paraardhës e për këtë arsye në zbatim të "Rregullores mbi përcaktimin e miratimin e pagesave rregullatore", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 190, datë 23.11.2017, e ndryshuar, i është vendosur shuma fikse.

- Duke qenë se ligji ka parashikuar të drejtën e ERE-s të marrë masa administrative të përshkallëzuara për llojin e shkeljes (mosshlyerje e pagesave të rregullimit të vitit 2022) që nga vendosja e gjobës e deri në heqjen e licencës, vlerësohet që në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore, këta të licencuar të trajtohen në mënyrë të barabartë, duke qenë se shkelja është e njëjtë për të gjithë dhe të vijohet me masën administrative që mund të aplikohet për të gjithë këta të licencuar,

duke filluar me procedurat përkatëse për heqjen e licencës, sipas parashikimeve të nenit 5, germa "ç" dhe nenit 6 të rregullores "Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017.

- Neni 6 i rregullores "Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 52, datë 18.4.2017, parashikon se, në çdo rast subjekti ndaj të cilit fillon një procedurë për heqjen e licencës duhet që me marrjen dijeni, të shlyejë çdo pagesë rregullatore të pashlyer ndaj ERE. Në asnjë rast subjekti i licencuar debitor, nuk çlirohet nga ky detyrim ndaj ERE, edhe pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurës për heqjen e licencës.

- Në nenin 7 të rregullores është parashikuar e drejta e të licencuari për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 449, seria P19, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "BE-IS Energy" sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 115, datë 22.7.2019.

2. I licencuari ka të drejtë për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

3. Grupi i punës të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 36, datë 20.2.2023

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS NR. 388, SERIA PV17K, PËR VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË "AFRIMI K" SHPK

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 42, pika 1, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" i ndryshuar; nenit 5, germa "ç"; neneve 6 dhe 7, të rregullores "Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; nenit 15 të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; pikës 6.1, germa "ç", të "Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 99, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.2.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 505/1 prot., datë 15.2.2023, të përgatitur nga grupi i punës, "Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitore për pagesat e rregullimit të vitit 2022 të pashlyera ndaj ERE-s",

konstatoi se:

- Shoqëria "Afrimi K" sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 388, seria PV17K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 172, datë 26.10.2017, për një afat 30-vjeçar.

- Me vendimin e Bordit nr. 124, datë 31.5.2022, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2022 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror.

- Vendimi i Bordit të ERE-s nr. 124/2022 është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 101, datë 7.7.2022. Përveç botimit në Fletoren Zyrtare, i licencuari është njoftuar për këtë vendim, edhe nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 1312 prot., datë 21.7.2022. Po ashtu, shoqërisë i është rinjoftuar detyrimi nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 1580 prot., datë 20.9.2022. Rezulton se shoqëria nuk e ka shlyer ende detyrimin e saj.

- Me urdhrin e kryetarit nr. 20, datë 30.1.2023, është ngritur grupi i punës për marrjen e masave administrative ndaj të licencuarve debitorë për

pagesat e rregullimit të vitit 2022, të pashlyera ndaj ERE-s.

- Rezulton se i licencuari "Afrimi K" sh.p.k. nuk e ka kundërshtuar vendimin e Bordit të ERE-s nr. 124/2022, dhe nuk ka përcjellë në ERE shpjegime dhe dokumentacion mbi mosshlyerjen e pagesës së rregullimit të vitit 2022.

- Grupi i Punës ka konstatuar nga ana e shoqërisë "Afrimi K" sh.p.k. shkeljen si vijon: mosshlyerjen në afat të pagesës së rregullimit për vitin 2022.

- Ligji nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, në nenin 107 parashikon se, për moskryerjen e pagesës rregullatore nga ana e të licencuarit brenda afatit të përcaktuar, ERE ndëshkon me gjobë deri në 3 për qind të të ardhurave të vitit paraardhës të të licencuarit si dhe ka të drejtë të aplikojë një kamatëvonesë mbi vlerën e pagesës rregullatore, në masën e 0.2% të xhiros ditore për çdo ditë vonesë në pagesën e saj dhe në germën "ç", të nenit 42 parashikon se, ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17 i këtij ligji.

- Sa i përket masës administrative "gjobë", referuar parashikimeve të sipërcituara ligjore, kalkulimi i masës së gjobës bëhet mbi bazën e të ardhurave vjetore të vitit financiar paraardhës të të licencuarit. Në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore dhe në bazë të të dhënave të ushtrimit të aktivitetit të licencuar, rezulton se kjo masë nuk mund të aplikohet për të gjitha subjektet debitore ndaj pagesës së rregullimit të vitit 2021, pasi ka subjekte të cilët nuk e kanë ushtruar veprimtarinë e licencuar për vitin paraardhës e për këtë arsye në zbatim të "Rregullores mbi përcaktimin e miratimin e pagesave rregullatore", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 190, datë 23.11.2017, i ndryshuar, i është vendosur shuma fikse.

- Duke qenë se ligji ka parashikuar të drejtën e ERE-s të marrë masa administrative të përshkallëzuara për llojin e shkeljes (mosshlyerje e pagesave të rregullimit të vitit 2022) që nga vendosja e gjobës e deri në heqjen e licencës, vlerësohet që në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore, këta të licencuar të trajtohen në mënyrë të barabartë, duke qenë se shkelja është e njëjtë për të gjithë dhe të vijohet me masën administrative që mund të aplikohet për të gjithë këta të licencuar, duke filluar me procedurat përkatëse për heqjen e licencës, sipas parashikimeve të nenit 5, germa "ç" dhe nenit 6 të rregullores "Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017.

- Neni 6 i rregullores "Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 52, datë 18.4.2017, parashikon se, në çdo rast subjekti ndaj të cilit fillon një procedurë për heqjen e licencës duhet që me marrjen dijeni, të shlyejë çdo pagesë rregullatore të pashlyer ndaj ERE-s. Në asnjë rast subjekti i licencuar debitor, nuk çlirohet nga ky detyrim ndaj ERE-s, edhe pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurës për heqjen e licencës.

- Në nenin 7 të rregullores është parashikuar e drejta e të licencuari për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 388, seria PV17K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Afrimi K" sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 172, datë 26.10.2017.

2. I licencuari ka të drejtë për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

3. Grupi i Punës të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 37, datë 20.2.2023

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS NR. 10, SERIA PV03, PËR VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË "EN.KU" SHPK

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 42, pika 1, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; nenit 5, germa "ç"; neneve 6 dhe 7, të rregullores "Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; nenit 15 të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; pikës 6.1, germa "ç", të "Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.2.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 505/1 prot., datë 15.2.2023, të përgatitur nga grupi i punës, "Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitore për pagesat e rregullimit të vitit 2022 të pashlyera ndaj ERE-s",

konstatoi se:

- Shoqëria "EN.KU" sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 10, seria PV03P, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 86, datë 17.7.2008, i ndryshuar, për një afat 30-vjeçar.

- Me vendimin e Bordit nr. 124, datë 31.5.2022, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2022 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror.

- Vendimi i Bordit të ERE-s nr. 124/2022 është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 101, datë 7.7.2022. Përveç botimit në Fletoren Zyrtare, i licencuari është njoftuar për këtë vendim, edhe nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 1262 prot., datë 21.7.2022. Po ashtu, shoqërisë i është rinjoftuar detyrimi nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 1590 prot., datë 20.9.2022. Rezulton se shoqëria nuk e ka shlyer ende detyrimin e saj.

- Me urdhrin e kryetarit nr. 20, datë 30.1.2023, është ngritur grupi i punës për marrjen e masave administrative ndaj të licencuarve debitorë për pagesat e rregullimit të vitit 2022, të pashlyera ndaj ERE-s.

- Rezulton se i licencuari "EN.KU" sh.p.k. nuk e ka kundërshtuar vendimin e Bordit të ERE-s nr. 124/2022, dhe nuk ka përcjellë në ERE shpjegime dhe dokumentacion mbi mosshlyerjen e pagesës së rregullimit të vitit 2022.

- Grupi i punës ka konstatuar nga ana e shoqërisë "EN.KU" sh.p.k. shkeljen si vijon: mosshlyerjen në afat të pagesës së rregullimit për vitin 2022.

- Ligji nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, në nenin 107, parashikon se: për moskryerjen e pagesës rregullatore nga ana e të licencuarit brenda afatit të përcaktuar, ERE ndëshkon me gjobë deri në 3 për qind të të ardhurave të vitit paraardhës të të licencuarit si dhe ka të drejtë të aplikojë një kamatëvonesë mbi vlerën e pagesës rregullatore, në masën e 0.2% të xhiros ditore për çdo ditë vonesë në pagesën e saj dhe në germën "ç", të nenit 42, parashikon se: ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17 i këtij ligji.

- Sa i përket masës administrative "gjobë", referuar parashikimeve të sipërcituara ligjore, kalkulimi i masës së gjobës bëhet mbi bazën e të ardhurave vjetore të vitit financiar paraardhës të të licencuarit. Në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore dhe në bazë të të dhënave të ushtrimit të aktivitetit të licencuar, rezulton se kjo masë nuk mund të aplikohet për të gjitha subjektet debitore ndaj pagesës së rregullimit të vitit 2021, pasi ka subjekte të cilët nuk e kanë ushtruar veprimtarinë e licencuar për vitin paraardhës e për këtë arsye në zbatim të "Rregullores mbi përcaktimin e miratimin e pagesave rregullatore" miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 190, datë 23.11.2017, e ndryshuar, i është vendosur shuma fikse.

- Duke qenë se ligji ka parashikuar të drejtën e ERE-s të marrë masa administrative të përshkallëzuara për llojin e shkeljes (mosshlyerje e pagesave të rregullimit të vitit 2022) që nga vendosja e gjobës e deri në heqjen e licencës, vlerësohet që në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore, këta të licencuar të trajtohen në mënyrë të barabartë, duke qenë se shkelja është e njëjtë për të gjithë dhe të vijohet me masën administrative që mund të aplikohet për të gjithë këta të licencuar,

duke filluar me procedurat përkatëse për heqjen e licencës, sipas parashikimeve të nenit 5, germa "ç" dhe nenit 6 të rregullores "Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017.

- Neni 6 i rregullores "Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 52, datë 18.4.2017, parashikon se, në çdo rast, subjekti ndaj të cilit fillon një procedurë për heqjen e licencës duhet që me marrjen dijeni, të shlyejë çdo pagesë rregullatore të pashlyer ndaj ERE. Në asnjë rast subjekti i licencuar debitor, nuk çlirohet nga ky detyrim ndaj ERE-s, edhe pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurës për heqjen e licencës.

- Në nenin 7 të rregullores është parashikuar e drejta e të licencuari për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 10, seria PV03P, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "EN.KU" sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 86, datë 17.7.2008, i ndryshuar.

2. I licencuari ka të drejtë për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

3. Grupi i Punës të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 38, datë 20.2.2023

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS NR. 185, SERIA PV12K, PËR VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE DHËNË SHOQËRISË "ENERGJI-XHAÇI" SHPK

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 42, pika 1, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 5, germa "ç"; neneve 6 dhe 7 të "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; pikës 6.1, germa "ç", të "Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.2.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 505/1 prot., datë 15.2.2023, të përgatitur nga grupi i punës, "Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitore për pagesat e rregullimit të vitit 2022 të pashlyerja ndaj ERE-s",

konstatoi se:

- Shoqëria "Energji-Xhaçi" sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 185, seria PV12K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 142, datë 10.10.2012, për një afat 30-vjeçar.

- Me vendimin e Bordit nr. 124, datë 31.5.2022, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2022 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror.

- Vendimi i Bordit të ERE-s nr. 124/2022 është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 101, datë 7.7.2022. Përveç botimit në Fletoren Zyrtare, i licencuari është njoftuar për këtë vendim, edhe nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 1249 prot., datë 21.7.2022. Po ashtu, shoqërisë i është rinjoftuar detyrimi nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 1591 prot., datë 20.9.2022. Rezulton se shoqëria nuk e ka shlyer ende detyrimin e saj.

- Me urdhrin e kryetarit nr. 20, datë 30.1.2023, është ngritur grupi i punës për marrjen e masave administrative ndaj të licencuarve debitorë për pagesat e rregullimit të vitit 2022, të pashlyera ndaj ERE-s.

- Rezulton se i licencuari "Energji-Xhaçi" sh.p.k. nuk e ka kundërshtuar vendimin e Bordit të ERE-s nr. 124/2022, dhe nuk ka përcjellë në ERE shpjegime dhe dokumentacion mbi mosshlyerjen e pagesës së rregullimit të vitit 2022.

- Grupi i punës ka konstatuar nga ana e shoqërisë Energji-Xhaçi" sh.p.k. shkeljen, si vijon: Mosshlyerjen në afat të pagesës së rregullimit për vitin 2022.

- Ligji nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, në nenin 107 parashikon, se për moskryerjen e pagesës rregullatore nga ana e të licencuarit brenda afatit të përcaktuar, ERE ndëshkon me gjobë deri në 3 për qind të të ardhurave të vitit paraardhës të të licencuarit, si dhe ka të drejtë të aplikojë një kamatëvonesë mbi vlerën e pagesës rregullatore, në masën e 0.2% të xhiros ditore për çdo ditë vonesë në pagesën e saj dhe në germën "ç" të nenit 42 parashikon, se ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17 i këtij ligji.

- Sa i përket masës administrative "gjobë", referuar parashikimeve të sipërcituara ligjore, kalkulimi i masës së gjobës bëhet mbi bazën e të ardhurave vjetore të vitit financiar paraardhës të të licencuarit. Në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore dhe në bazë të të dhënave të ushtrimit të aktivitetit të licencuar, rezulton se kjo masë nuk mund të aplikohet për të gjitha subjektet debitore ndaj pagesës së rregullimit të vitit 2021, pasi ka subjekte të cilat nuk e kanë ushtruar veprimtarinë e licencuar për vitin paraardhës e për këtë arsye në zbatim të "Rregullores për miratimin e pagesave rregullatore", i është vendosur shuma fikse.

- Duke qenë se ligji ka parashikuar të drejtën e ERE-s të marrë masa administrative të përshkallëzuara për llojin e shkeljes (mosshlyerje e pagesave të rregullimit të vitit 2022) që nga vendosja e gjobës e deri në heqjen e licencës, vlerësohet që në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore, këta të licencuar të trajtohen në mënyrë të barabartë, duke qenë se shkelja është e njëjtë për të gjithë dhe të vijohet me masën administrative që mund të aplikohet për të gjithë këta të licencuar, duke filluar me procedurat përkatëse për heqjen e licencës, sipas parashikimeve të nenit 5, germa "ç" dhe nenit 6 të "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017.

- Neni 6 i "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 52, datë 18.4.2017, parashikon se, në çdo rast, subjekti ndaj të cilit fillon një procedurë për heqjen e licencës duhet që me marrjen dijeni, të shlyejë çdo pagesë rregullatore të pashlyer ndaj ERE-s. Në asnjë rast subjekti i licencuar debitor, nuk çlirohet nga ky detyrim ndaj ERE-s, edhe pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurës për heqjen e licencës.

- Në nenin 7 të Rregullores është parashikuar e drejta e të licencuari për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 185, seria PV12K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Energji-Xhaçi" sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 142, datë 10.10.2012.

2. I licencuari ka të drejtë për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

3. Grupi i punës të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 39, datë 20.2.2023

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS NR. 415, SERIA P18K, PËR VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE DHËNË SHOQËRISË "BLAC ENERGY" SHPK

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 42, pika 1, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 5, germa "ç"; neneve 6 dhe 7 të "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; pikës 6.1, germa "ç", të "Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.2.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 505/1 prot., datë 15.2.2023, të përgatitur nga grupi i punës, "Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitore për pagesat e rregullimit të vitit 2022 të pashlyerja ndaj ERE-s",

konstatoi se:

- Shoqëria "Blac Energy" sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 415, seria P18K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 157, datë 9.7.2018, për një afat 30-vjeçar.

- Me vendimin e bordit nr. 124, datë 31.5.2022, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2022 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror.

- Vendimi i Bordit të ERE-s i sipërcituar është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 101, datë 7.7.2022. Përveç botimit në Fletoren Zyrtare, i licencuari është njoftuar për këtë vendim, edhe nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 1319 prot., datë 21.7.2022. Po ashtu, shoqërisë i është rinjoftuar detyrimi nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 1597 prot., datë 20.9.2022. Rezulton se shoqëria nuk e ka shlyer ende detyrimin e saj.

- Me urdhrin e kryetarit nr. 20, datë 30.1.2023, është ngritur grupi i punës për marrjen e masave administrative ndaj të licencuarve debitorë për pagesat e rregullimit të vitit 2022, të pashlyera ndaj ERE-s.

- Rezulton se i licencuari "Blac Energy"sh.p.k. nuk e ka kundërshtuar vendimin e Bordit të ERE-s nr. 124/2022 dhe nuk ka përcjellë në ERE shpjegime dhe dokumentacion mbi mosshlyerjen e pagesës së rregullimit të vitit 2022.

- Grupi i punës ka konstatuar nga ana e shoqërisë "Blac Energy" sh.p.k. shkeljen si vijon: Mosshlyerjen në afat të pagesës së rregullimit për vitin 2022.

- Ligji nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, në nenin 107 parashikon, se: për moskryerjen e pagesës rregullatore nga ana e të licencuarit brenda afatit të përcaktuar, ERE ndëshkon me gjobë deri në 3 për qind të të ardhurave të vitit paraardhës të të licencuari, si dhe ka të drejtë të aplikojë një kamatëvonesë mbi vlerën e pagesës rregullatore, në masën e 0.2 % të xhiros ditore për çdo ditë vonesë në pagesën e saj, dhe në germën "ç" të nenit 42 parashikon, se, ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17 i këtij ligji.

- Sa i përket masës administrative "gjobë", referuar parashikimeve të sipërcituara ligjore, kalkulimi i masës së gjobës bëhet mbi bazën e të ardhurave vjetore të vitit financiar paraardhës të të licencuarit. Në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore dhe në bazë të të dhënave të ushtrimit të aktivitetit të licencuar, rezulton se kjo masë nuk mund të aplikohet për të gjitha subjektet debitore ndaj pagesës së rregullimit të vitit 2021, pasi ka subjekte të cilat nuk e kanë ushtruar veprimtarinë e licencuar për vitin paraardhës dhe për këtë arsye në zbatim të "Rregullores mbi përcaktimin e miratimin e pagesave rregullatore", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 190, datë 23.11.2017, të ndryshuar, i është vendosur shuma fikse.

- Duke qenë se ligji ka parashikuar të drejtën e ERE-s të marrë masa administrative të përshkallëzuara për llojin e shkeljes (mosshlyerje e pagesave të rregullimit të vitit 2022) që nga vendosja e gjobës e deri në heqjen e licencës, vlerësohet që në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore, këta të licencuar të trajtohen në mënyrë të barabartë, duke qenë se shkelja është e njëjtë për të gjithë dhe të vijohet me masën administrative që mund të aplikohet për të gjithë këta të licencuar,

duke filluar me procedurat përkatëse për heqjen e licencës, sipas parashikimeve të nenit 5, germa "ç" dhe nenit 6 të "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017.

- Neni 6 i "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 52, datë 18.4.2017, parashikon se, në çdo rast, subjekti ndaj të cilit fillon një procedurë për heqjen e licencës duhet që me marrjen dijeni, të shlyejë çdo pagesë rregullatore të pashlyer ndaj ERE-s. Në asnjë rast subjekti i licencuar debitor nuk çlirohet nga ky detyrim ndaj ERE-s, edhe pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurës për heqjen e licencës.

- Në nenin 7 të Rregullores është parashikuar e drejta e të licencuari për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 415, seria P18K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Blac Energy" sh.p.k. me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 157, datë 9.7.2018.

2. I licencuari ka të drejtë për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

3. Grupi i punës të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 40, datë 20.2.2023

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS NR. 14, SERIA PV03P, PËR VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË "JUANA" SHPK

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 42, pika 1, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; nenit 5, germa "ç"; nenit 6 dhe 7 të rregullores "Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; nenit 15 të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17..6.2016; pikës 6.1, germa "ç", të "Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike" miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 99, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.2.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 505/1 prot., datë 15.2.2023, të përgatitur nga grupi i punës, "Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitore për pagesat e rregullimit të vitit 2022 të pashlyera ndaj ERE-s",

konstatoi se:

- Shoqëria "Juana" sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 14, seria PV03P, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 5, datë 12.3.2004, i ndryshuar, për një afat 30-vjeçar.

- Me vendimin e Bordit nr. 124, datë 31.5.2022, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2022 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror.

- Vendimi i Bordit të ERE-s sipërcituar është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 101, datë 7.7.2022. Përveç botimit në Fletoren Zyrtare, i licencuari është njoftuar për këtë vendim, edhe nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 1264 prot., datë 21.7.2022. Po ashtu, shoqërisë i është rinjoftuar detyrimi nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 1604 prot., datë 20.9.2022. Rezulton se shoqëria nuk e ka shlyer ende detyrimin e saj.

- Me urdhrin e kryetarit nr. 20, datë 30.1.2023, është ngritur grupi i punës për marrjen e masave

administrative ndaj të licencuarve debitorë për pagesat e rregullimit të vitit 2022, të pashlyera ndaj ERE-s.

- Rezulton se i licencuari "Juana" sh.p.k. nuk e ka kundërshtuar vendimin e Bordit të ERE-s nr. 124/2022, dhe nuk ka përcjellë në ERE shpjegime dhe dokumentacion mbi mosshlyerjen e pagesës së rregullimit të vitit 2022.

- Grupi i punës ka konstatuar nga ana e shoqërisë "Juana" sh.p.k. shkeljen si vijon: mosshlyerjen në afat të pagesës së rregullimit për vitin 2022.

- Ligji nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, në nenin 107, parashikon se: për moskryerjen e pagesës rregullatore nga ana e të licencuarit brenda afatit të përcaktuar, ERE ndëshkon me gjobë deri në 3 për qind të të ardhurave të vitit paraardhës të të licencuarit si dhe ka të drejtë të aplikojë një kamatëvonesë mbi vlerën e pagesës rregullatore, në masën e 0.2% të xhiros ditore për çdo ditë vonesë në pagesën e saj dhe në germën "ç", të nenit 42, parashikon se: ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17 i këtij ligji.

- Sa i përket masës administrative "gjobë", referuar parashikimeve të sipërcituara ligjore, kalkulimi i masës së gjobës bëhet mbi bazën e të ardhurave vjetore të vitit financiar paraardhës të të licencuarit. Në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore dhe në bazë të të dhënave të ushtrimit të aktivitetit të licencuar, rezulton se kjo masë nuk mund të aplikohet për të gjitha subjektet debitore ndaj pagesës së rregullimit të vitit 2021, pasi ka subjekte të cilët nuk e kanë ushtruar veprimtarinë e licencuar për vitin paraardhës e për këtë arsye në zbatim të "Rregullores mbi përcaktimin e miratimin e pagesave rregullatore", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 190, datë 23.11.2017, e ndryshuar, i është vendosur shuma fikse.

- Duke qenë se ligji ka parashikuar të drejtën e ERE-s të marrë masa administrative të përshkallëzuara për llojin e shkeljes (mosshlyerje e pagesave të rregullimit të vitit 2022) që nga vendosja e gjobës e deri në heqjen e licencës, vlerësohet që në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore, këta të licencuar të trajtohen në mënyrë të barabartë, duke qenë se shkelja është e njëjtë për të gjithë dhe të vijohet me masën administrative që mund të aplikohet për të gjithë këta të licencuar, duke filluar me procedurat përkatëse për heqjen e licencës, sipas parashikimeve të nenit 5, germa "ç" dhe nenit 6, të rregullores "Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017.

- Neni 6 i rregullores "Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 52, datë 18.4.2017, parashikon se: në çdo rast, subjekti ndaj të cilit fillon një procedurë për heqjen e licencës duhet që me marrjen dijeni, të shlyejë çdo pagesë rregullatore të pashlyer ndaj ERE-s. Në asnjë rast subjekti i licencuar debitor nuk çlirohet nga ky detyrim ndaj ERE-s, edhe pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurës për heqjen e licencës.

- Në nenin 7 të rregullores është parashikuar e drejta e të licencuari për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 14, seria PV03P, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Juana" sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 5, datë 12.3.2004, i ndryshuar.

2. I licencuari ka të drejtë për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

3. Grupi i punës të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 41, datë 20.2.2023

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS NR. 129, SERIA PV11K, PËR VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË "SELISHTE" SHPK

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 42, pika 1, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; nenit 5, germa "ç"; neneve 6 dhe 7, të rregullores "Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; nenit 15 të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; pikës 6.1, germa "ç", të "Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, date 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.2.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 505/1 prot., datë 15.2.2023, të përgatitur nga grupi i punës, "Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitore për pagesat e rregullimit të vitit 2022 të pashlyera ndaj ERE-s",

konstatoi se:

- Shoqëria "Selishte" sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 129, seria PV11K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 60, datë 22.6.2011, për një afat 30-vjeçar.

- Me vendimin e Bordit nr. 124, datë 31.5.2022, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2022 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror.

- Vendimi i Bordit të ERE-s sipërcituar është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 101, datë 7.7.2022. Përveç botimit në Fletoren Zyrtare, i licencuari është njoftuar për këtë vendim, edhe nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 1229 prot., datë 21.7.2022. Po ashtu, shoqërisë i është rinjoftuar detyrimi nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 1229/1 prot., datë 20.9.2022. Rezulton se shoqëria nuk e ka shlyer ende detyrimin e saj.

- Me urdhrin e kryetarit nr. 20, datë 30.1.2023, është ngritur grupi i punës për marrjen e masave administrative ndaj të licencuarve debitorë për pagesat e rregullimit të vitit 2022, të pashlyera ndaj ERE-s.

- Rezulton se i licencuari "Selishte" sh.p.k. nuk e ka kundërshtuar vendimin e bordit të ERE-s nr. 124/2022, dhe nuk ka përcjellë në ERE shpjegime dhe dokumentacion mbi mosshlyerjen e pagesës së rregullimit të vitit 2022.

- Grupi i punës ka konstatuar nga ana e shoqërisë "Selishte" sh.p.k. shkeljen si vijon: mosshlyerjen në afat të pagesës së rregullimit për vitin 2022.

- Ligji nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, në nenin 107 parashikon se, për moskryerjen e pagesës rregullatore nga ana e të licencuarit brenda afatit të përcaktuar, ERE ndëshkon me gjobë deri në 3 për qind të të ardhurave të vitit paraardhës të të licencuarit si dhe ka të drejtë të aplikojë një kamatëvonesë mbi vlerën e pagesës rregullatore, në masën e 0.2% të xhiros ditore për çdo ditë vonesë në pagesën e saj dhe në germën "ç", të nenit 42, parashikon se: ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17 i këtij ligji.

- Sa i përket masës administrative "gjobë", referuar parashikimeve të sipërcituara ligjore, kalkulimi i masës së gjobës bëhet mbi bazën e të ardhurave vjetore të vitit financiar paraardhës të të licencuarit. Në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore dhe në bazë të të dhënave të ushtrimit të aktivitetit të licencuar, rezulton se kjo masë nuk mund të aplikohet për të gjitha subjektet debitore ndaj pagesës së rregullimit të vitit 2021, pasi ka subjekte të cilët nuk e kanë ushtruar veprimtarinë e licencuar për vitin paraardhës e për këtë arsye në zbatim të "Rregullores mbi përcaktimin e miratimin e pagesave rregullatore", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 190, datë 23.11.2017, e ndryshuar, i është vendosur shuma fikse.

- Duke qenë se ligji ka parashikuar të drejtën e ERE-s të marrë masa administrative të përshkallëzuara për llojin e shkeljes (mosshlyerje e pagesave të rregullimit të vitit 2022) që nga vendosja e gjobës e deri në heqjen e licencës, vlerësohet që në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore, këta të licencuar të trajtohen në mënyrë të barabartë, duke qenë se shkelja është e njëjtë për të gjithë dhe të vijohet me masën administrative që mund të aplikohet për të gjithë këta të licencuar,

duke filluar me procedurat përkatëse për heqjen e licencës, sipas parashikimeve të nenit 5, germa "ç" dhe nenit 6 të rregullores "Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017.

- Neni 6 i rregullores "Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 52, datë 18.4.2017, parashikon se: në çdo rast, subjekti ndaj të cilit fillon një procedurë për heqjen e licencës duhet që me marrjen dijeni, të shlyejë çdo pagesë rregullatore të pashlyer ndaj ERE-s. Në asnjë rast subjekti i licencuar debitor nuk çlirohet nga ky detyrim ndaj ERE-s, edhe pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurës për heqjen e licencës.

- Në nenin 7 të rregullores është parashikuar e drejta e të licencuari për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 129, seria PV11K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Selishte" sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 60, datë 22.6.2011.

2. I licencuari ka të drejtë për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

3. Grupi i punës të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 42, datë 20.2.2023

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS NR. 392, SERIA PV17K, PËR VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË "SIMA-COM" SHPK

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 42, pika 1, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike" i ndryshuar; nenit 5, germa "ç"; neneve 6 dhe 7, të rregullores "Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; nenit 15 të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; pikës 6.1, germa "ç", të "Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.2.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 505/1 prot., datë 15.2.2023, të përgatitur nga grupi i punës, "Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitore për pagesat e rregullimit të vitit 2022 të pashlyera ndaj ERE-s",

konstatoi se:

- Shoqëria "Sima-Com" sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 392, seria PV17K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 194, datë 24.11.2017, për një afat 30-vjeçar.

- Me vendimin e Bordit nr. 124, datë 31.5.2022, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2022 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror.

- Vendimi i Bordit të ERE-s nr. 124/2022 është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 101, datë 7.7.2022. Përveç botimit në Fletoren Zyrtare, i licencuari është njoftuar për këtë vendim, edhe nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 1313 prot., datë 21.7.2022. Po ashtu, shoqërisë i është rinjoftuar detyrimi nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 1313/1 prot., datë 20.9.2022. Rezulton se shoqëria nuk e ka shlyer ende detyrimin e saj.

- Me urdhrin e kryetarit nr. 20, datë 30.1.2023, është ngritur grupi i punës për marrjen e masave

administrative ndaj të licencuarve debitorë për pagesat e rregullimit të vitit 2022, të pashlyera ndaj ERE-s.

- Rezulton se i licencuari "Sima-Com" sh.p.k. nuk e ka kundërshtuar vendimin e Bordit të ERE-s nr. 124/2022, dhe nuk ka përcjellë në ERE shpjegime dhe dokumentacion mbi mosshlyerjen e pagesës së rregullimit të vitit 2022.

- Grupi i punës ka konstatuar nga ana e shoqërisë "Sima-Com" sh.p.k. shkeljen si vijon: mosshlyerjen në afat të pagesës së rregullimit për vitin 2022.

- Ligji nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, në nenin 107, parashikon se: për moskryerjen e pagesës rregullatore nga ana e të licencuarit brenda afatit të përcaktuar, ERE ndëshkon me gjobë deri në 3 për qind të të ardhurave të vitit paraardhës të të licencuarit, si dhe ka të drejtë të aplikojë një kamatëvonesë mbi vlerën e pagesës rregullatore, në masën e 0.2% të xhiros ditore për çdo ditë vonesë në pagesën e saj dhe në germën "ç", të nenit 42 parashikon se, ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17 i këtij ligji.

- Sa i përket masës administrative "gjobë", referuar parashikimeve të sipërcituara ligjore, kalkulimi i masës së gjobës bëhet mbi bazën e të ardhurave vjetore të vitit financiar paraardhës të të licencuarit. Në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore dhe në bazë të të dhënave të ushtrimit të aktivitetit të licencuar, rezulton se kjo masë nuk mund të aplikohet për të gjitha subjektet debitore ndaj pagesës së rregullimit të vitit 2021, pasi ka subjekte të cilët nuk e kanë ushtruar veprimtarinë e licencuar për vitin paraardhës e për këtë arsye në zbatim të "Rregullores mbi përcaktimin e miratimin e pagesave rregullatore", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 190, datë 23.11.2017, e ndryshuar, i është vendosur shuma fikse.

- Duke qenë se ligji ka parashikuar të drejtën e ERE-s të marrë masa administrative të përshkallëzuara për llojin e shkeljes (mosshlyerje e pagesave të rregullimit të vitit 2022) që nga vendosja e gjobës e deri në heqjen e licencës, vlerësohet që në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore, këta të licencuar të trajtohen në mënyrë të barabartë, duke qenë se shkelja është e njëjtë për të gjithë dhe të vijohet me masën administrative që mund të aplikohet për të gjithë këta të licencuar, duke filluar me procedurat përkatëse për heqjen e licencës, sipas parashikimeve të nenit 5, germa "ç" dhe nenit 6 të rregullores "Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017.

- Neni 6 i rregullores "Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 52, datë 18.4.2017, parashikon se, në çdo rast, subjekti ndaj të cilit fillon një procedurë për heqjen e licencës duhet që me marrjen dijeni, të shlyejë çdo pagesë rregullatore të pashlyer ndaj ERE-s. Në asnjë rast subjekti i licencuar debitor nuk çlirohet nga ky detyrim ndaj ERE-s, edhe pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurës për heqjen e licencës.

- Në nenin 7 të rregullores është parashikuar e drejta e të licencuari për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 392, seria PV17K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Sima-Com" sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 194, datë 24.11.2017.

2. I licencuari ka të drejtë për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

3. Grupi i punës të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 43, datë 20.2.2023

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS NR. 125, SERIA PV11K, PËR VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË "HEC-I DRAGOSTUNJE" SHPK

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 42, pika 1, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" i ndryshuar; nenit 5, germa "ç"; nenit 6 dhe 7 të rregullores "Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; nenit 15 të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; pikës 6.1, germa "ç", të "Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike" miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.2.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 505/1 prot., datë 15.2.2023, të përgatitur nga grupi i punës, "Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitore për pagesat e rregullimit të vitit 2022 të pashlyera ndaj ERE-s",

konstatoi se:

- Shoqëria "HEC-I DRAGOSTUNJE" sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 392, seria PV17K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 194, datë 24.11.2017, për një afat 30-vjeçar.

- Me vendimin e Bordit nr. 124, datë 31.5.2022, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2022 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror.

- Vendimi i Bordit të ERE-s nr. 124/2022 është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 101, datë 7.7.2022. Përveç botimit në Fletoren Zyrtare, i licencuari është njoftuar për këtë vendim, edhe nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 1225 prot., datë 21.7.2022. Po ashtu, shoqërisë i është rinjoftuar detyrimi nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 1607 prot., datë 20.9.2022. Rezulton se shoqëria nuk e ka shlyer ende detyrimin e saj.

- Me urdhrin e kryetarit nr. 20, datë 30.1.2023, është ngritur grupi i punës për marrjen e masave administrative ndaj të licencuarve debitorë për pagesat e rregullimit të vitit 2022, të pashlyera ndaj ERE-s.

- Rezulton se i licencuari "HEC-I Dragostunje" sh.p.k. nuk e ka kundërshtuar vendimin e Bordit të ERE-s nr. 124/2022, dhe nuk ka përcjellë në ERE shpjegime dhe dokumentacion mbi mosshlyerjen e pagesës së rregullimit të vitit 2022.

- Grupi i punës ka konstatuar nga ana e shoqërisë "HEC-I Dragostunje" sh.p.k. shkeljen si vijon: mosshlyerjen në afat të pagesës së rregullimit për vitin 2022.

- Ligji nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, në nenin 107, parashikon se: për moskryerjen e pagesës rregullatore nga ana e të licencuarit brenda afatit të përcaktuar, ERE ndëshkon me gjobë deri në 3 për qind të të ardhurave të vitit paraardhës të të licencuarit, si dhe ka të drejtë të aplikojë një kamatëvonesë mbi vlerën e pagesës rregullatore, në masën e 0.2% të xhiros ditore për çdo ditë vonesë në pagesën e saj dhe në germën "ç", të nenit 42, parashikon se: ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17 i këtij ligji.

- Sa i përket masës administrative "gjobë", referuar parashikimeve të sipërcituara ligjore, kalkulimi i masës së gjobës bëhet mbi bazën e të ardhurave vjetore të vitit financiar paraardhës të të licencuarit. Në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore dhe në bazë të të dhënave të ushtrimit të aktivitetit të licencuar, rezulton se kjo masë nuk mund të aplikohet për të gjitha subjektet debitore ndaj pagesës së rregullimit të vitit 2021, pasi ka subjekte të cilët nuk e kanë ushtruar veprimtarinë e licencuar për vitin paraardhës e për këtë arsye në zbatim të "Rregullores mbi përcaktimin e miratimin e pagesave rregullatore", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 190, datë 23.11.2017, e ndryshuar, i është vendosur shuma fikse.

- Duke qenë se ligji ka parashikuar të drejtën e ERE-s të marrë masa administrative të përshkallëzuara për llojin e shkeljes (mosshlyerje e pagesave të rregullimit të vitit 2022) që nga vendosja e gjobës e deri në heqjen e licencës, vlerësohet që në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore, këta të licencuar të trajtohen në mënyrë të barabartë, duke qenë se shkelja është e njëjtë për të gjithë dhe të vijohet me masën administrative që mund të aplikohet për të gjithë këta të licencuar,

duke filluar me procedurat përkatëse për heqjen e licencës, sipas parashikimeve të nenit 5, germa "ç" dhe nenit 6 të rregullores "Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017.

- Neni 6 i rregullores "Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 52, datë 18.4.2017, parashikon se: në çdo rast, subjekti ndaj të cilit fillon një procedurë për heqjen e licencës duhet që me marrjen dijeni, të shlyejë çdo pagesë rregullatore të pashlyer ndaj ERE-s. Në asnjë rast subjekti i licencuar debitor nuk çlirohet nga ky detyrim ndaj ERE-s, edhe pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurës për heqjen e licencës.

- Në nenin 7 të rregullores është parashikuar e drejta e të licencuari për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 125, seria PV11K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "HEC-I Dragostunje" sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 25, datë 10.3.2011.

2. I licencuari ka të drejtë për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

3. Grupi i Punës të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 44, datë 20.2.2023

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS NR. 126, SERIA T11P, PËR VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË "HEC-I DRAGOSTUNJE" SHPK

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 42, pika 1, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; nenit 5, germa "ç"; neneve 6 dhe 7, të rregullores "Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; nenit 15 të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; pikës 5.1, germa "ç", të "Kushteve të licencës së tregtimit të energjisë elektrike"; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.2.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 505/1 prot., datë 15.2.2023, të përgatitur nga grupi i punës, "Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitore për pagesat e rregullimit të vitit 2022 të pashlyera ndaj ERE-s",

konstatoi se:

- Shoqëria "HEC-I Dragostunje" sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 126, seria T11P, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 26, datë 10.3.2011, për një afat 30-vjeçar.

- Me vendimin e Bordit nr. 124, datë 31.5.2022, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2022 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror.

- Vendimi i Bordit të ERE-s nr. 124/2022 është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 101, datë 7.7.2022. Përveç botimit në Fletoren Zyrtare, i licencuari është njoftuar për këtë vendim, edhe nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 1225 prot., datë 21.7.2022. Po ashtu, shoqërisë i është rinjoftuar detyrimi nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 1607 prot., datë 20.9.2022. Rezulton se shoqëria nuk e ka shlyer ende detyrimin e saj.

- Me urdhrin e kryetarit nr. 20, datë 30.1.2023, është ngritur grupi i punës për marrjen e masave administrative ndaj të licencuarve debitorë për

pagesat e rregullimit të vitit 2022, të pashlyera ndaj ERE-s.

- Rezulton se i licencuari "HEC-I Dragostunje" sh.p.k. nuk e ka kundërshtuar vendimin e Bordit të ERE-s nr. 124/2022, dhe nuk ka përcjellë në ERE shpjegime dhe dokumentacion mbi mosshlyerjen e pagesës së rregullimit të vitit 2022.

- Grupi i punës ka konstatuar nga ana e shoqërisë "HEC-I Dragostunje" sh.p.k. shkeljen si vijon: mosshlyerjen në afat të pagesës së rregullimit për vitin 2022.

- Ligji nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, në nenin 107 parashikon se, për moskryerjen e pagesës rregullatore nga ana e të licencuarit brenda afatit të përcaktuar, ERE ndëshkon me gjobë deri në 3 për qind të të ardhurave të vitit paraardhës të të licencuarit si dhe ka të drejtë të aplikojë një kamatëvonesë mbi vlerën e pagesës rregullatore, në masën e 0.2% të xhiros ditore për çdo ditë vonesë në pagesën e saj dhe në gemën "ç", të nenit 42, parashikon se: ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17 i këtij ligji.

- Sa i përket masës administrative "gjobë", referuar parashikimeve të sipërcituara ligjore, kalkulimi i masës së gjobës bëhet mbi bazën e të ardhurave vjetore të vitit financiar paraardhës të të licencuarit. Në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore dhe në bazë të të dhënave të ushtrimit të aktivitetit të licencuar, rezulton se kjo masë nuk mund të aplikohet për të gjitha subjektet debitore ndaj pagesës së rregullimit të vitit 2021, pasi ka subjekte të cilët nuk e kanë ushtruar veprimtarinë e licencuar për vitin paraardhës e për këtë arsye në zbatim të "Rregullores mbi përcaktimin e miratimin e pagesave rregullatore", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 190, datë 23.11.2017, e ndryshuar, i është vendosur shuma fikse.

- Duke qenë se ligji ka parashikuar të drejtën e ERE-s të marrë masa administrative të përshkallëzuara për llojin e shkeljes (mosshlyerje e pagesave të rregullimit të vitit 2022), që nga vendosja e gjobës e deri në heqjen e licencës, vlerësohet që në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore, këta të licencuar të trajtohen në mënyrë të barabartë, duke qenë se shkelja është e njëjtë për të gjithë dhe të vijohet me masën administrative që mund të aplikohet për të gjithë këta të licencuar, duke filluar me procedurat përkatëse për heqjen e licencës, sipas parashikimeve të nenit 5, germa "ç" dhe nenit 6 të rregullores "Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017.

- Neni 6 i rregullores "Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 52, datë 18.4.2017, parashikon se: në çdo rast, subjekti ndaj të cilit fillon një procedurë për heqjen e licencës duhet që me marrjen dijeni, të shlyejë çdo pagesë rregullatore të pashlyer ndaj ERE-s. Në asnjë rast subjekti i licencuar debitor nuk çlirohet nga ky detyrim ndaj ERE-s, edhe pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurës për heqjen e licencës.

- Në nenin 7 të rregullores është parashikuar e drejta e të licencuari për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 126, seria T11P, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "HEC-I Dragostunje" sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 26, datë 10.3.2011.

2. I licencuari ka të drejtë për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

3. Grupi i Punës të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 45, datë 20.2.2023

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS NR. 280, SERIA PV15K, PËR VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË "KOXHERRI ENERGJI" SHPK

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 42, pika 1, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike" i ndryshuar; nenit 5, germa "ç"; nenit 6 dhe 7 të rregullores "Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; nenit 15 të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; pikës 6.1, germa "ç", të "Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike" miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.2.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 505/1 prot., datë 15.2.2023, të përgatitur nga grupi i punës, "Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitore për pagesat e rregullimit të vitit 2022 të pashlyerja ndaj ERE-s",

konstatoi se:

- Shoqëria "Koxherri Energji" sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 280, seria PV15K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 51, datë 17.4.2015, për një afat 30-vjeçar.

- Me vendimin e Bordit nr. 124, datë 31.5.2022, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2022 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror.

- Vendimi i Bordit të ERE-s nr. 124/2022 është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 101, datë 7.7.2022. Përveç botimit në Fletoren Zyrtare, i licencuari është njoftuar për këtë vendim, edhe nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 1280 prot., datë 21.7.2022. Po ashtu, shoqërisë i është rinjoftuar detyrimi nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 1280/1 prot., datë 20.9.2022. Rezulton se shoqëria nuk e ka shlyer ende detyrimin e saj.

- Me urdhrin e kryetarit nr. 20, datë 30.1.2023, është ngritur grupi i punës për marrjen e masave administrative ndaj të licencuarve debitorë për pagesat e rregullimit të vitit 2022, të pashlyera ndaj ERE-s.

- Rezulton se i licencuari "Koxherri Energji" sh.p.k. nuk e ka kundërshtuar vendimin e Bordit të ERE-s nr. 124/2022, dhe nuk ka përcjellë në ERE shpjegime dhe dokumentacion mbi mosshlyerjen e pagesës së rregullimit të vitit 2022.

- Grupi i punës ka konstatuar nga ana e shoqërisë "Koxherri Energji" sh.p.k. shkeljen si vijon: mosshlyerjen në afat të pagesës së rregullimit për vitin 2022.

- Ligji nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, në nenin 107, parashikon se: për moskryerjen e pagesës rregullatore nga ana e të licencuarit brenda afatit të përcaktuar, ERE ndëshkon me gjobë deri në 3 për qind të të ardhurave të vitit paraardhës të të licencuarit, si dhe ka të drejtë të aplikojë një kamatëvonesë mbi vlerën e pagesës rregullatore, në masën e 0.2 % të xhiros ditore për çdo ditë vonesë në pagesën e saj dhe në germën "ç", të nenit 42, parashikon se: ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17 i këtij ligji.

- Sa i përket masës administrative "gjobë", referuar parashikimeve të sipërcituara ligjore, kalkulimi i masës së gjobës bëhet mbi bazën e të ardhurave vjetore të vitit financiar paraardhës të të licencuarit. Në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore dhe në bazë të të dhënave të ushtrimit të aktivitetit të licencuar, rezulton se kjo masë nuk mund të aplikohet për të gjitha subjektet debitore ndaj pagesës së rregullimit të vitit 2021, pasi ka subjekte të cilët nuk e kanë ushtruar veprimtarinë e licencuar për vitin paraardhës e për këtë arsye në zbatim të "Rregullores mbi përcaktimin e miratimin e pagesave rregullatore", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 190, datë 23.11.2017, e ndryshuar, i është vendosur shuma fikse.

- Duke qenë se ligji ka parashikuar të drejtën e ERE-s të marrë masa administrative të përshkallëzuara për llojin e shkeljes (mosshlyerje e pagesave të rregullimit të vitit 2022), që nga vendosja e gjobës e deri në heqjen e licencës, vlerësohet që në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore, këta të licencuar të trajtohen në mënyrë të barabartë, duke qenë se shkelja është e njëjtë për të gjithë dhe të vijohet me masën administrative që mund të aplikohet për të gjithë këta të licencuar,

duke filluar me procedurat përkatëse për heqjen e licencës, sipas parashikimeve të nenit 5, germa "ç" dhe nenit 6 të rregullores "Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017.

- Neni 6 i rregullores "Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 52, datë 18.4.2017, parashikon se, në çdo rast, subjekti ndaj të cilit fillon një procedurë për heqjen e licencës duhet që me marrjen dijeni, të shlyejë çdo pagesë rregullatore të pashlyer ndaj ERE-s. Në asnjë rast subjekti i licencuar debitor nuk çlirohet nga ky detyrim ndaj ERE-s, edhe pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurës për heqjen e licencës.

- Në nenin 7 të rregullores është parashikuar e drejta e të licencuari për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 280, seria PV15K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Koxherri Energji" sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 51, datë 17.4.2015.

2. I licencuari ka të drejtë për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

3. Grupi i Punës të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 46, datë 20.2.2023

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS NR. 292, SERIA T15P, PËR VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË "KOXHERRI ENERGJI" SHPK

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 42, pika 1, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" i ndryshuar; nenit 5, germa "ç"; neneve 6 dhe 7, të rregullores "Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; nenit 15 të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; pikës 5.1, germa "ç", të "Kushteve të licencës së tregtimit të energjisë elektrike"; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.2.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 505/1 prot., datë 15.2.2023, të përgatitur nga grupi i punës, "Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitore për pagesat e rregullimit të vitit 2022 të pashlyera ndaj ERE-s",

konstatoi se:

- Shoqëria "Koxherri Energji" sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 292, seria T15P, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 71, datë 13.5.2015, për një afat 30-vjeçar.

- Me vendimin e Bordit nr. 124, datë 31.5.2022, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2022 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror.

- Vendimi i Bordit të ERE-s nr. 124/2022 është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 101, datë 7.7.2022. Përveç botimit në Fletoren Zyrtare, i licencuari është njoftuar për këtë vendim, edhe nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 1280 prot., datë 21.7.2022. Po ashtu, shoqërisë i është rinjoftuar detyrimi nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 1280/1 prot., datë 20.9.2022. Rezulton se shoqëria nuk e ka shlyer ende detyrimin e saj.

- Me urdhrin e kryetarit nr. 20, datë 30.1.2023, është ngritur grupi i punës për marrjen e masave administrative ndaj të licencuarve debitorë për

pagesat e rregullimit të vitit 2022, të pashlyera ndaj ERE-s.

- Rezulton se i licencuari "Koxherri Energji" sh.p.k. nuk e ka kundërshtuar vendimin e Bordit të ERE-s nr. 124/2022, dhe nuk ka përcjellë në ERE shpjegime dhe dokumentacion mbi mosshlyerjen e pagesës së rregullimit të vitit 2022.

- Grupi i Punës ka konstatuar nga ana e shoqërisë "Koxherri Energji" sh.p.k. shkeljen si vijon: mosshlyerjen në afat të pagesës së rregullimit për vitin 2022.

- Ligji nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, në nenin 107 parashikon se: për moskryerjen e pagesës rregullatore nga ana e të licencuarit brenda afatit të përcaktuar, ERE ndëshkon me gjobë deri në 3 për qind të të ardhurave të vitit paraardhës të të licencuarit si dhe ka të drejtë të aplikojë një kamatëvonesë mbi vlerën e pagesës rregullatore, në masën e 0.2% të xhiros ditore për çdo ditë vonesë në pagesën e saj dhe në germën "ç", të nenit 42, parashikon se: ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17 i këtij ligji.

- Sa i përket masës administrative "gjobë", referuar parashikimeve të sipërcituara ligjore, kalkulimi i masës së gjobës bëhet mbi bazën e të ardhurave vjetore të vitit financiar paraardhës të të licencuarit. Në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore dhe në bazë të të dhënave të ushtrimit të aktivitetit të licencuar, rezulton se kjo masë nuk mund të aplikohet për të gjitha subjektet debitore ndaj pagesës së rregullimit të vitit 2021, pasi ka subjekte të cilët nuk e kanë ushtruar veprimtarinë e licencuar për vitin paraardhës e për këtë arsye në zbatim të "Rregullores mbi përcaktimin e miratimin e pagesave rregullatorë", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 190, datë 23.11.2017, e ndryshuar, i është vendosur shuma fikse.

- Duke qenë se ligji ka parashikuar të drejtën e ERE-s të marrë masa administrative të përshkallëzuara për llojin e shkeljes (mosshlyerje e pagesave të rregullimit të vitit 2022), që nga vendosja e gjobës e deri në heqjen e licencës, vlerësohet që në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore, këta të licencuar të trajtohen në mënyrë të barabartë, duke qenë se shkelja është e njëjtë për të gjithë dhe të vijohet me masën administrative që mund të aplikohet për të gjithë këta të licencuar, duke filluar me procedurat përkatëse për heqjen e licencës, sipas parashikimeve të nenit 5, germa "ç" dhe nenit 6 të rregullores "Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017.

- Neni 6 i rregullores "Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 52, datë 18.4.2017, parashikon se në çdo rast, subjekti ndaj të cilit fillon një procedurë për heqjen e licencës duhet që me marrjen dijeni, të shlyejë çdo pagesë rregullatore të pashlyer ndaj ERE-s. Në asnjë rast subjekti i licencuar debitor, nuk çlirohet nga ky detyrim ndaj ERE-s, edhe pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurës për heqjen e licencës.

- Në nenin 7 të rregullores është parashikuar e drejta e të licencuari për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës Nr. 292, Seria T15P, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Koxherri Energji" sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 71, datë 13.5.2015.

2. I licencuari ka të drejtë për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

3. Grupi i Punës të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 47, datë 20.2.2023

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS NR. 136, SERIA T11P, PËR VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË "ERMA M.P." SH.P.K.

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 42, pika 1, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike" i ndryshuar; nenit 5, germa "ç"; neneve 6 dhe 7, të rregullores "Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; nenit 15 të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; pikës 5.1, germa "ç", të "Kushteve të licencës së tregtimit të energjisë elektrike"; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.2.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 505/1 prot., datë 15.2.2023, të përgatitur nga grupi i punës, "Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitore për pagesat e rregullimit të vitit 2022 të pashlyerja ndaj ERE-s",

konstatoi se:

- Shoqëria "Erma M.P." sh.p.k. është mbajtëse e licencës n. 136, seria T11P, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 17.10.2021, për një afat 30-vjeçar.

- Me vendimin e Bordit nr. 124, datë 31.5.2022, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2022 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror.

- Vendimi i Bordit të ERE-s nr. 124/2022 është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 101, datë 7.7.2022. Përveç botimit në Fletoren Zyrtare, i licencuari është njoftuar për këtë vendim, edhe nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 1230 prot., datë 21.7.2022. Po ashtu, shoqërisë i është rinjoftuar detyrimi nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 1602 prot., datë 20.9.2022. Rezulton se shoqëria nuk e ka shlyer ende detyrimin e saj.

- Me urdhrin e kryetarit nr. 20, datë 30.1.2023, është ngritur grupi i punës për marrjen e masave administrative ndaj të licencuarve debitorë për pagesat e rregullimit të vitit 2022, të pashlyera ndaj ERE-s.

- Rezulton se i licencuari "Erma M.P." sh.p.k. nuk e ka kundërshtuar vendimin e Bordit të ERE-s nr. 124/2022, dhe nuk ka përcjellë në ERE shpjegime dhe dokumentacion mbi mosshlyerjen e pagesës së rregullimit të vitit 2022.

- Grupi i punës ka konstatuar nga ana e shoqërisë "Erma M.P." sh.p.k. shkeljen si vijon: mosshlyerjen në afat të pagesës së rregullimit për vitin 2022.

- Ligji nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, në nenin 107, parashikon se: për moskryerjen e pagesës rregullatore nga ana e të licencuarit brenda afatit të përcaktuar, ERE ndëshkon me gjobë deri në 3 për qind të të ardhurave të vitit paraardhës të të licencuarit si dhe ka të drejtë të aplikojë një kamatëvonesë mbi vlerën e pagesës rregullatore, në masën e 0.2% të xhiros ditore për çdo ditë vonesë në pagesën e saj dhe në germën "ç", të nenit 42, parashikon se: ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17 i këtij ligji.

- Sa i përket masës administrative "gjobë", referuar parashikimeve të sipërcituara ligjore, kalkulimi i masës së gjobës bëhet mbi bazën e të ardhurave vjetore të vitit financiar paraardhës të të licencuarit. Në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore dhe në bazë të të dhënave të ushtrimit të aktivitetit të licencuar, rezulton se kjo masë nuk mund të aplikohet për të gjitha subjektet debitore ndaj pagesës së rregullimit të vitit 2021, pasi ka subjekte të cilët nuk e kanë ushtruar veprimtarinë e licencuar për vitin paraardhës e për këtë arsye në zbatim të "Rregullores mbi përcaktimin e miratimin e pagesave rregullatore", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 190, datë 23.11.2017, i ndryshuar, i është vendosur shuma fikse.

- Duke qenë se ligji ka parashikuar të drejtën e ERE-s të marrë masa administrative të përshkallëzuara për llojin e shkeljes (mosshlyerje e pagesave të rregullimit të vitit 2022), që nga vendosja e gjobës e deri në heqjen e licencës, vlerësohet që në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore, këta të licencuar të trajtohen në mënyrë të barabartë, duke qenë se shkelja është e njëjtë për të gjithë dhe të vijohet me masën administrative që mund të aplikohet për të gjithë këta të licencuar, duke filluar me procedurat përkatëse për heqjen e

licencës, sipas parashikimeve të nenit 5, germa "ç" dhe nenit 6, të rregullores "Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017.

- Neni 6 i rregullores "Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 52, datë 18.4.2017, parashikon se, në çdo rast, subjekti ndaj të cilit fillon një procedurë për heqjen e licencës duhet që me marrjen dijeni, të shlyejë çdo pagesë rregullatore të pashlyer ndaj ERE-s. Në asnjë rast subjekti i licencuar debitor nuk çlirohet nga ky detyrim ndaj ERE-s, edhe pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurës për heqjen e licencës.

- Në nenin 7 të rregullores është parashikuar e drejta e të licencuari për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 136, seria T11P, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Erma M.P." sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 17.10.2011.

2. I licencuari ka të drejtë për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

3. Grupi i Punës të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 48, datë 20.2.2023

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS NR. 454, SERIA T19, PËR VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË "ELECTRAL BATRA HPP" SHPK

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 42, pika 1, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 5, germa "ç"; neneve 6 dhe 7 të "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; pikës 5.1, germa "ç", të "Kushteve të licencës së tregtimit të energjisë elektrike"; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.2.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 505/1 prot., datë 15.2.2023, të përgatitur nga grupi i punës, "Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitore për pagesat e rregullimit të vitit 2022 të pashlyerja ndaj ERE-s",

konstatoi se:

- Shoqëria "Electral Batra HPP" sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 454, seria T19, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 153, datë 21.10.2019, për një afat 5-vjeçar.

- Me vendimin e bordit nr. 124, datë 31.5.2022, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2022 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror.

- Vendimi i Bordit të ERE-s nr. 124/2022 është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 101, datë 7.7.2022. Përveç botimit në Fletoren Zyrtare, i licencuari është njoftuar për këtë vendim, edhe nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 1230 prot., datë 21.7.2022. Po ashtu, shoqërisë i është rinjoftuar detyrimi nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 1602 prot., datë 20.9.2022. Rezulton se shoqëria nuk e ka shlyer ende detyrimin e saj.

- Me urdhrin e kryetarit nr. 20, datë 30.1.2023, është ngritur grupi i punës për marrjen e masave

administrative ndaj të licencuarve debitorë për pagesat e rregullimit të vitit 2022, të pashlyera ndaj ERE-s.

- Rezulton se i licencuari "Electral Batra HPP" sh.p.k. nuk e ka kundërshtuar vendimin e Bordit të ERE-s nr. 124/2022, dhe nuk ka përcjellë në ERE shpjegime dhe dokumentacion mbi mosshlyerjen e pagesës së rregullimit të vitit 2022.

- Grupi i punës ka konstatuar nga ana e shoqërisë "Electral Batra HPP" sh.p.k. shkeljen si vijon: Mosshlyerjen në afat të pagesës së rregullimit për vitin 2022.

- Ligji nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, në nenin 107 parashikon se, për moskryerjen e pagesës rregullatore nga ana e të licencuarit brenda afatit të përcaktuar, ERE ndëshkon me gjobë deri në 3 për qind të të ardhurave të vitit paraardhës të të licencuarit, si dhe ka të drejtë të aplikojë një kamatëvonesë mbi vlerën e pagesës rregullatore, në masën e 0.2 % të xhiros ditore për çdo ditë vonesë në pagesën e saj dhe në germën "ç" të nenit 42 parashikon se, ERE heq një licencë, kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17 i këtij ligji.

- Sa i përket masës administrative "gjobë", referuar parashikimeve të sipërcituara ligjore, kalkulimi i masës së gjobës bëhet mbi bazën e të ardhurave vjetore të vitit financiar paraardhës të të licencuarit. Në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore dhe në bazë të të dhënave të ushtrimit të aktivitetit të licencuar, rezulton se kjo masë nuk mund të aplikohet për të gjitha subjektet debitore ndaj pagesës së rregullimit të vitit 2021, pasi ka subjekte të cilat nuk e kanë ushtruar veprimtarinë e licencuar për vitin paraardhës e për këtë arsye në zbatim të "Rregullores mbi përcaktimin e miratimin e pagesave rregullatore", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 190, datë 23.11.2017, të ndryshuar, i është vendosur shuma fikse.

- Duke qenë se ligji ka parashikuar të drejtën e ERE-s të marrë masa administrative të përshkallëzuara për llojin e shkeljes (mosshlyerje e pagesave të rregullimit të vitit 2022) që nga vendosja e gjobës e deri në heqjen e licencës, vlerësohet që në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore, këta të licencuar të trajtohen në mënyrë të barabartë, duke qenë se shkelja është e njëjtë për të gjithë dhe të vijohet me masën administrative që mund të aplikohet për të gjithë këta të licencuar, duke filluar me procedurat përkatëse për heqjen e licencës, sipas parashikimeve të nenit 5, germa "ç", dhe nenit 6 të "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017.

- Neni 6 i "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 52, datë 18.4.2017, parashikon se, në çdo rast, subjekti ndaj të cilit fillon një procedurë për heqjen e licencës duhet që me marrjen dijeni, të shlyejë çdo pagesë rregullatore të pashlyer ndaj ERE-s. Në asnjë rast, subjekti i licencuar debitor nuk çlirohet nga ky detyrim ndaj ERE-s edhe pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurës për heqjen e licencës.

- Në nenin 7 të Rregullores është parashikuar e drejta e të licencuari për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 454, seria T19, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Electral Batra HPP" sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 153, datë 21.10.2019.

2. I licencuari ka të drejtë për t'u përgjigjur me shkrim, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

3. Grupi i punës të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 49, datë 20.2.2023

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS NR. 446, SERIA T19, PËR VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË "TERNA ENERGY TRADING" SHPK

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 42, pika 1, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 5, germa "ç", neneve 6 dhe 7 të "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.6.2016; pikës 5.1, germa "ç", të "Kushteve të licencës së tregtimit të energjisë elektrike"; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.2.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 505/1 prot., datë 15.2.2023, të përgatitur nga grupi i punës, "Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitore për pagesat e rregullimit të vitit 2022 të pashlyerja ndaj ERE-s",

konstatoi se:

- Shoqëria "Terna Energy Trading" sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 446, seria T19, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 105, datë 20.6.2019, për një afat 5-vjeçar.

- Me vendimin e Bordit nr. 124, datë 31.5.2022, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2022 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror.

- Vendimi i Bordit të ERE-s i sipërcituar është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 101, datë 7.7.2022. Përveç botimit në Fletoren Zyrtare, i licencuari është njoftuar për këtë vendim, edhe nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 1230 prot., datë 21.7.2022. Po ashtu, shoqërisë i është rinjoftuar detyrimi nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 1602 prot., datë 20.9.2022. Rezulton se shoqëria nuk e ka shlyer ende detyrimin e saj.

- Me urdhrin e kryetarit nr. 20, datë 30.1.2023, është ngritur grupi i punës për marrjen e masave administrative ndaj të licencuarve debitorë për pagesat e rregullimit të vitit 2022, të pashlyera ndaj ERE-s.

- Rezulton se i licencuari "Terna Energy Trading" sh.p.k. nuk e ka kundërshtuar vendimin e Bordit të ERE-s nr. 124/2022 dhe nuk ka përcjellë në ERE shpjegime dhe dokumentacion mbi mosshlyerjen e pagesës së rregullimit të vitit 2022.

- Grupi i punës ka konstatuar nga ana e shoqërisë "Terna Energy Trading" sh.p.k. shkeljen si vijon: Mosshlyerjen në afat të pagesës së rregullimit për vitin 2022.

- Ligji nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, në nenin 107 parashikon, se për moskryerjen e pagesës rregullatore nga ana e të licencuarit brenda afatit të përcaktuar, ERE ndëshkon me gjobë deri në 3 për qind të të ardhurave të vitit paraardhës të të licencuarit, si dhe ka të drejtë të aplikojë një kamatëvonesë mbi vlerën e pagesës rregullatore, në masën e 0.2% të xhiros ditore për çdo ditë vonesë në pagesën e saj dhe në germën "ç" të nenit 42 parashikon, se ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17 i këtij ligji.

- Sa i përket masës administrative "gjobë", referuar parashikimeve të sipërcituara ligjore, kalkulimi i masës së gjobës bëhet mbi bazën e të ardhurave vjetore të vitit financiar paraardhës të të licencuarit. Në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore dhe në bazë të të dhënave të ushtrimit të aktivitetit të licencuar, rezulton se kjo masë nuk mund të aplikohet për të gjitha subjektet debitore ndaj pagesës së rregullimit të vitit 2021, pasi ka subjekte të cilët nuk e kanë ushtruar veprimtarinë e licencuar për vitin paraardhës e për këtë arsye në zbatim "Rregullores mbi përcaktimin e miratimin e pagesave rregullatorë", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 190, datë 23.11.2017, e ndryshuar, i është vendosur shuma fikse.

- Duke qenë se ligji ka parashikuar të drejtën e ERE-s të marrë masa administrative të përshkallëzuara për llojin e shkeljes (mosshlyerje e pagesave të rregullimit të vitit 2022) që nga vendosja e gjobës e deri në heqjen e licencës, vlerësohet që në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore, këta të licencuar të trajtohen në mënyrë të barabartë, duke qenë se shkelja është e njëjtë për të gjithë dhe të vijohet me masën administrative që mund të aplikohet për të gjithë këta të licencuar,

duke filluar me procedurat përkatëse për heqjen e licencës, sipas parashikimeve të nenit 5, germa "ç" dhe nenit 6 të "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017.

- Neni 6 i "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 52, datë 18.4.2017, parashikon se, në çdo rast, subjekti ndaj të cilit fillon një procedurë për heqjen e licencës duhet që me marrjen dijeni, të shlyejë çdo pagesë rregullatore të pashlyer ndaj ERE. Në asnjë rast subjekti i licencuar debitor, nuk çlirohet nga ky detyrim ndaj ERE, edhe pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurës për heqjen e licencës.

- Në nenin 7 të Rregullores është parashikuar e drejta e të licencuari për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 446, seria T19, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Terna Energy Trading" sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 105, datë 26.6.2019.

2. I licencuari ka të drejtë për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.

3. Grupi i punës të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 50, datë 20.2.2023

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "SUN ENERGY SOLUTIONS" SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 mw, NË SHEQ MARINAS, TOPOJË, BASHKIA FIER

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa "a", nenit 5, pika 1, germa "a", dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, germa "a" të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s" nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.2.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 571/1 prot., datë 18.2.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë 'Sun Energy Solutions' sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 mw, në Sheq Marinas, Topojë, Bashkia Fier",

konstatoi se:

- Shoqëria "Sun Energy Solutions" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 571 prot., datë 6.2.2023, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në fshatin Sheq Marinar, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Në zbatim të përcaktimeve të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë

në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e prodhimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.1); shtojcën 1, shtojcën 1A dhe shtojcën 2 të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të një aplikimi (aneksi A).

- Aplikuesi ka kryer pagesën, sipas përcaktimeve të aneksit A, "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria "Sun Energy Solutions" sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të rregullores për nenin 9, pikën 1.1, germat "a", "b" dhe "c"; për pikën 1.2, germat "a" dhe "d"; për pikën 1.3, germën "c"; për pikën 2, germat "a", "b", "d" "e" dhe "f".

- Nga ky aplikim rezulton, gjithashtu, se nevojitet të plotësohet dokumentacioni, si vijon:

Neni 9:

- Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1, "Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë"

Pika 1.2, "Dokumentacioni juridik dhe administrativ"

- Germa "b": Aplikuesi duhet të depozitojë vërtetimin e gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti) për administratorin dhe për vetë shoqërinë "Sun Energy Solutions" sh.p.k.

- Germa "c": Aplikuesi duhet të depozitojë në ERE strukturën organizative të shoqërisë "Sun Energy Solutions" sh.p.k., së bashku me stafin teknik të dedikuar për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

Pika 1.3, "Dokumentacioni financiar dhe fiskal":

- Germa "a": Aplikuesi duhet të bëjë me dije nëse ka shlyer gjobën ndaj institucionit të Sigurimeve Shoqërore dhe nëse po, të depozitojë në ERE vërtetimin përkatës për shlyerjen e të gjitha detyrimeve.

- Germa "b": Aplikuesi duhet të depozitojë letrën e referencës së bankës, origjinale ose fotokopje të njësuar me origjinalin dhe të bëjë me dije hapat e ndjekur për nënshkrimin e kontratës apo marrëveshjes përkatëse me bankën dhe nëse kjo marrëveshje është nënshkruar, duhet ta depozitojë në ERE.

Aplikuesi duhet të depozitojë në ERE aktet përkatëse për të materializuar marrëveshjen e bashkëpunimit dhe/ose llogari bankare të shoqërisë, dokumente në të cilat duhet të vërtetohet se ajo zotëron aftësinë financiare për të garantuar 20% të vlerës së investimit, sipas parashikimeve të planit të biznesit të depozituar nga vetë ajo.

Pika 2, "Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës"

Pika 2.1:

- Germa "c": Aplikuesi duhet të depozitojë në ERE, në format origjinal, ose fotokopje të njësuar me origjinalin, shkresën e OSSH sh.a. dhe marrëveshjen përkatëse për lidhjen me rrjetin. Po ashtu, duhet të bëjë me dije, nëse ka ndodhur ndryshimi i pikës së lidhjes që referohet në shkresën e OSSH sh.a.

- Gjithashtu, aplikuesi duhet të bëjë me dije nëse ka filluar punimet për ndërtimin e centralit.

- ERE, në zbatim të nenit 38, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, dhe të nenit 5 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet, por duke qenë se nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik jetëgjatësia e pritshme e centralit rezulton të jetë 25 vjet, atëherë ERE kushtëzohet nga kjo jetëgjatësi në dhënien e afatit maksimal për këtë licencë fotovoltaike, deri në 25 vjet.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Sun Energy Solutions" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në Sheq Marinas, Topojë, Bashkia Fier, për një afat 25-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të

Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 51, datë 20.2.2023

MBI MOS FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "ENERGY 24" SHPK NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa "f", nenit 5, pika 1, germa "d", dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, germa "a" të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.2.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 593/2 prot., datë 15.2.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë 'Energy 24' sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Shoqëria "Energy 24" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE nr. 593 prot., datë 7.2.2023, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Në zbatim të përcaktimeve të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.4); shtojcën 1 dhe shtojcën 1/D të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (aneksi A).

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria "Energy 24" sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9 për pikën 1.1, germat "a", "b" dhe "c"; për pikën 1.2, germat "a", "b", "c", "d"; për pikën 2.4, germat "a", "b", "c" dhe "d".

- Nga ky aplikim rezulton se mungon dokumentacioni, si vijon:

Pika 1.3, "Dokumentacioni financiar dhe fiskal":

- Germa "a": Konstatohet se dokumenti "Detyrimet në kohë reale" nuk është ai i lëshuar sipas kërkesës së kësaj pike të rregullores dhe në vijim do t'i kërkohet shoqërisë ta përcjellë atë në ERE, Vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve ndaj institucionit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

- Germa "b": Në përmbushje të kërkesave të kësaj pike të rregullores, t'i kërkohet shoqërisë që të depozitojë në ERE pasqyrat financiare të vitit 2021 në format origjinal/fotokopje të njësuar me origjinalin dhe, gjithashtu, të depozitojë pasqyrat financiare për vitet 2019 dhe 2020, të cilat mungojnë. Po ashtu shoqëria duhet të dokumentojë/depozitojë në ERE dokumentacion vërtetues (si p.sh. vërtetim llogarie bankare, apo hua/kredi) mbi disponimin nga ana e saj të vlerës financiare për të realizuar të paktën një muaj aktivitetin për të cilën kërkon të licencohet.

- Germa "c": Shoqëria ka depozituar në ERE një plan biznesi, i cili nuk i përket ushtrimit të veprimtarisë së furnizimit, por veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike, për këtë arsye t'i kërkohet shoqërisë të përcjellë në ERE, planin e biznesit për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, sipas kërkesave të kësaj pike të rregullores.

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit në zbatim të aneksit A të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien,

modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.

- Në kuadër të mosplotësimit nga aplikuesi të dokumentacionit thelbësor, sipas kërkesave të rregullores, vlerësohet mosfillimi i procedurës për këtë aplikim.

- Në mbështetje të parashikimit të nenit 10, pika 7, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nëse aplikuesi, brenda 1 (një) muaji nga marrja dijeni e vendimit për mosfillimin e procedurës, paraqet dokumentacionin thelbësor të konstatuar të munguar, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm dhe pagesa për aplikim do të konsiderohen të vlefshme për fillimin e procedurës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Energy 24" sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Aplikuesi mund të paraqesë një aplikim të ri brenda 1 (një) muaji nga marrja e vendimit të Bordit të ERE-s dhe dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm dhe pagesa do të konsiderohet i vlefshëm edhe për aplikimin e ri.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 52, datë 20.2.2023

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "ATEANI ENERGY" SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HIDROCENTRALET "SHUTRI 1", ME KAPACITET TË INSTALUAR 370 kw DHE "SHUTRI 2", ME KAPACITET 1600 kw, ME KAPACITET TOTAL TË INSTALUAR 1970 kw

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa "a", nenit 5, pika 1 germa "a", nenit 10, pikat 1 dhe 3 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa "a" të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.2.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 22/5 prot., datë 15.2.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë 'Ateani Energy' sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet 'Shutri 1' me kapacitet të instaluar 370 kw dhe 'Shutri 2' me kapacitet 1600 kw, me kapacitet total të instaluar 1970 kw",

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 333, datë 19.12.2022, vendosi të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Ateani Energy" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Në vijim ERE, me shkresën nr. 22 prot., datë 6.1.2023, ka njoftuar shoqërinë për këtë vendim dhe i ka bërë me dije se në mbështetje të përcaktimeve të nenit 10, pika 7, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike",

të ndryshuar, nëse shoqëria, brenda 1 (një) muaji nga marrja dijeni e vendimit për mosfillimin e procedurës, paraqet dokumentacionin thelbësor të konstatuar të munguar, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm dhe pagesa për aplikim do të konsiderohen të vlefshme për fillimin e procedurës.

- Shoqëria "Ateani Energy" sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 22/1 prot., datë 7.2.2023, brenda afatit të sipërcituar ka përcjellë dokumentacion plotësues për aplikimin për t'u licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Në zbatim të përcaktimeve të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e prodhimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.1); shtojcën 1, shtojcën 1A dhe shtojcën 2 të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të një aplikimi (aneksi A).

- Aplikuesi ka kryer pagesën e aplikimit, sipas përcaktimeve të aneksit A "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.

- Nga aplikimi rezulton se shoqëria "Ateani Energy" sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, germat "a", "b", "c"; për pikën 1.2, germat "a", "b", "c", "d"; për pikën 1.3, germat "b" dhe "c"; për pikën 2, germat "a", "b", "c", "d", "e".

- Nga ky aplikim rezulton, gjithashtu, se mungon dokumentacioni si vijon:

Neni 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1.3, "Dokumentacioni financiar dhe fiskal"

- Germa "a": Shoqëria ka përcjellë vetëm vërtetimin e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, i cili nuk është i integruar me atë të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore, për këtë arsye t'i kërkohet shoqërisë të përcjellë në ERE-s dhe këtë vërtetim.

- Në lidhje me shitjen e kuotave të kapitalit në datën 13.4.2022 nga "Ateani" sh.p.k. te shoqëria "Besniku" sh.p.k., i cili është realizuesi i investimeve të nevojshme deri në vënien në punë të HEC-eve, vlerësohet që në kuptim të nenit 17 të kontratës koncesionare, e cila përcakton se, për çdo transferim të aksioneve/të kapitalit themeltar të saj tek të tretët, të marrë pëlqimin paraprak të autoritetit kontraktor, t'i kërkohet shoqërisë të informojë ERE-n, nëse ka marrë pëlqimin paraprak të MIE-s në cilësinë e autoritetit kontraktor për këtë shitje.

- Kontrata e koncesionit e formës BOT (ndërtim-operim-transferim), për ndërtimin e hidrocentraleve "Shutri 1" dhe "Shutri 2", me nr. 2234 rep., 1083/2 kol., datë 15.8.2017, ka një afat 35-vjeçar. Nga ana tjetër shpjegojmë se ERE, në zbatim të nenit 38 të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, dhe nenit 5 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nuk mund të japë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të madh se 30 vjet, por në rast konstatimi të humbjes së periudhës së koncesionit, licenca do të jepet për periudhën e mbetur të koncesionit. Në rastin konkret nëse deri në fund të procedurës së licencimit shoqëria do të dokumentojë lejen e përdorimit të burimit ujor me afat koncesionar, siç më sipërcituar, atëherë ERE do të shprehet me licencim për periudhën e mbetur të koncesionit 29 vjet e 5 muaj.

- Ndërsa në rast se shoqëria deri në fund të procedurës së licencimit nuk do të ketë përcjellë në ERE lejen e përditësuar të përdorimit të burimit ujor, atëherë ERE do të shprehet me licencë, sipas afatit të mbetur të lejes së përdorimit të burimit ujor, pra deri në datën 25.7.2023.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Ateani Energy" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, hidrocentralet "Shutri 1" me kapacitet të instaluar 370 kw dhe "Shutri 2" me kapacitet 1600 kw, me kapacitet total të instaluar 1970 kw.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 53, datë 20.2.2023

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "ATEANI ENERGY" SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa "e", nenit 5, pika 1, germa "e", nenit 10, pikat 1 dhe 3 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 19 pika 1, germa "a" të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.2.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 22/4 prot., datë 15.2.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë 'Ateani Energy' sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 334, datë 19.12.2022, vendosi të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Ateani Energy" sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në vijim, ERE me shkresën nr. 22 prot., datë 6.1.2023, ka njoftuar shoqërinë për këtë vendim dhe i ka bërë me dije se në mbështetje të përcaktimeve të nenit 10, pika 7, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nëse shoqëria, brenda 1 (një) muaji nga marrja dijeni e vendimit për mosfillimin e procedurës, paraqet dokumentacionin thelbësor të konstatuar të munguar, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm dhe pagesa për aplikim do të konsiderohen të vlefshme për fillimin e procedurës.

- Shoqëria "Ateani Energy" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE nr. 22/1 prot., datë 7.2.2023, brenda afatit të sipërcituar ka përcjellë dokumentacion plotësues për aplikimin e saj për t'u licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në zbatim të përcaktimeve të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.5); shtojcën 1 dhe shtojcën 1E të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (aneksi A).

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike në zbatim të aneksit A të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.

- Nga aplikimi rezulton se shoqëria "Ateani Energy" sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, germat "a", "b", "c"; për pikën 1.2, germat "a", "b" dhe "d"; për pikën 1.3, germat "b" dhe "c" dhe pikën 2.5.

- Nga ky aplikim rezulton, gjithashtu, se mungon dokumentacioni si vijon:

Neni 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim:

- Pika 1.2, "Dokumentacioni juridik dhe administrativ"

- Germa "c": Shoqëria ka depozituar të njëjtën strukturë organizative për veprimtarinë e prodhimit dhe të tregtimit të energjisë elektrike, për këtë arsye shoqëria duhet të përcjellë në ERE strukturën e dedikuar për veprimtarinë e tregtimit për të cilën kërkon të licencohet.

- Pika 1.3, "Dokumentacioni financiar dhe fiskal"

- Germa "a": Shoqëria ka përcjellë vetëm vërtetimin e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, i cili nuk është i integruar me vërtetimin e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore, për këtë arsye shoqëria duhet të përcjellë në ERE dhe këtë vërtetim.

- Për dokumentacionin e munguar do të njoftohet aplikuesi që ta depozitojë atë brenda afatit të përcaktuar nga ERE.

- Në kuadër të plotësimit nga aplikuesi të dokumentacionit thelbësor, sipas kërkesave të rregullores, vlerësohet fillimi i procedurës për këtë aplikim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Ateani Energy" sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 5, datë 22.2.2023

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME TIRANË SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence" (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar (rregullore e licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 22.2.2023 pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike dhe Sektori Juridik mbi kërkesën e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Tiranë sh.a. për licencim

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Tiranë (UK Tiranë) me shkresën nr. 1002 prot., datë 23.1.2023, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim licence për shkak të mbarimit të afatit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesë për licencim për shkak të mbarimit të afatit të UK Tiranë në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM- në nr. 958 dhe rregulloren e licencimit.

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) shoqëria UK Tiranë ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 862 009 banorë në Bashkinë Tiranë;

b) drejtues ligjor i shoqërisë është z. Elton Kacidhja.

c) drejtues teknik i shoqërisë është z. Edgar Çani i diplomuar në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Elektrike, dega "Elektrikë", në vitin 1985 dhe ka mbi 5 vjet përvojë në profesion, sipas kritereve të përcaktuara në VKM nr. 958;

d) drejtues teknik i shoqërisë për impiantin është z. Enton Osmani i diplomuar në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, dega "Mjedis", profili "Energjetikë" në vitin 2004 dhe ka mbi 5 vjet përvojë në profesion, sipas kritereve të përcaktuara në VKM nr. 958.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Tiranë, të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar (ligji nr. 9121) për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Tiranë është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Tiranë sh.a., me NUIS L72320033P në kategoritë:

a) kategoria A: "Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik";

b) kategoria B: "Për përpunimin e ujit për konsum publik";

c) kategoria C: "Për largimin e ujërave të ndotura".

2. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Tiranë sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

a) drejtues ligjor: Elton Kacidhja;

b) drejtues teknik: Edgar Çani;

c) drejtues teknik: Enton Osmani.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Tiranë sh.a. është Bashkia Tiranë.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Tiranë sh.a. detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Tiranë sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

VENDIM
Nr. 6, datë 22.2.2023

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME DURRËS SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence" (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar (rregullore e licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 22.2.2023, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi miratimin e vendimit 'Për licencimin e shoqërisë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Durrës sh.a.'",

KONSTATON SE:

1. Shoqëria rajonale Ujësjellës-Kanalizime Durrës sh.a., me shkresën nr. 554 prot. datë 30.1.2022, me lëndë "Kërkesë për pajisje me licencë" ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për licencim.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim të shoqërisë rajonale UK Durrës sh.a. në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe rregulloren e licencimit, "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM-së nr. 302, datë 11.5.2022, "Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura" (VKM nr. 302).

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) shoqëria rajonale Ujësjellës-Kanalizime Durrës sh.a. (NUIS M22031502M) është themeluar më datë 13.7.2022, me aksionarë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me 51%, bashkitë: Durrës me 32.47%, Shijak me 2.43%, Rrogozhinë me 2.16%, Krujë me 3.45%, Kavajë me 8.49%;

b) shoqëria rajonale UK Durrës sh.a. ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 472,148 banorë të bashkive: Durrës, Shijak, Rrogozhinë, Krujë, Kavajë;

c) drejtues teknik i shoqërisë z. Gerald Dautaj është diplomuar në Universitetin Politeknik, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, me master shkencor në "Hidroteknikë", në vitin 2012 dhe plotëson kërkesat e VKM-së nr. 958 mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion;

d) drejtues teknik i shoqërisë z. Bledar Metalla është diplomuar në Universitetin Politeknik, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, me master shkencor në "Hidroteknikë", në vitin 2012 dhe plotëson kërkesat e VKM nr. 958 mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim për herë të parë ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e shoqërisë rajonale UK Durrës sh.a., të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për mbrojtjen e Konkurrencës", të ndryshuar (ligji nr. 9121) për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve;

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e shoqërisë rajonale UK Durrës sh.a. është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Durrës sh.a. me (NUIS M22031502M), në kategoritë:

a) kategoria A: "Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik";

b) kategoria B: "Për përpunimin e ujit për konsumim publik";

c) kategoria C: "Për largimin e ujërave të ndotura";

d) kategoria D: "Për përpunimin e ujërave të ndotura".

2. Shoqëria rajonale Ujësjellës-Kanalizime Durrës sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

a) drejtues ligjor: Spartak Kovaçi;

b) drejtues teknik: Gerald Dautaj;

c) drejtues teknik: Bledar Metalla.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Durrës sh.a. janë bashkitë: Durrës, Shijak, Rrogozhinë, Krujë, Kavajë.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Durrës sh.a. detyrohet të nënshkruajë

kushtet e licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Durrës sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

7. Vendimi i KKRR-së nr. 344, datë 23.9.2021, "Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Durrës sh.a.", shfuqizohet. Vendimi i KKRR-së nr. 272, datë 30.3.2021, "Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Krujë sh.a.", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

VENDIM
Nr. 7, datë 22.2.2023

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME GJIROKASTËR SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence" (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar (rregullore e licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR
RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 22.2.2023 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi miratimin e vendimit 'Për licencimin e shoqërisë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Gjirokastër sh.a.'",

KONSTATON SE:

1. Shoqëria rajonale Ujësjellës-Kanalizime Gjirokastër sh.a., me shkresën 383 prot. datë 29.12.2022, plotësimet me anë të shkresës me nr. 383/1 prot., datë 25.1.2023 dhe nr. 324/1 prot. datë 10.2.2023, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për licencim.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim të shoqërisë rajonale UK Gjirokastër sh.a. në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe rregulloren e licencimit, "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM nr. 302, datë 11.5.2022 "Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura" (VKM nr. 302).

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) shoqëria rajonale Ujësjellës-Kanalizime Gjirokastër sh.a. (NUIS M23329601L) është themeluar më datë 22.9.2022, me aksionarë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me 51%, bashkitë: Gjirokastër me 21.24%, Tepelenë me 4.57%, Këlcyrë me 2.81%, Përmet me 7.65%, Libohovë me 2.46%, Dropull me 7.05%, Memaliaj me 3.22%;

b) shoqëria rajonale UK Gjirokastër sh.a. ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 128 156 banorë të bashkive: Gjirokastër, Tepelenë, Këlcyrë, Përmet, Libohovë, Dropull, Memaliaj;

c) drejtues teknik i shoqërisë z. Bashkim Tola është diplomuar në Universitetin Politeknik në Inxhinieri e shpimit të puseve të z. Bashkim Tola në vitin 1997 dhe plotëson kërkesat e VKM-së nr. 958 mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion.

